



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 482/16 Prot.

Tiranë, më 22.06.2018

V E N D I M

Nr.56, Datë 22.06.2018

PËR

**MBI EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NJËSITË E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE ME FINANCIME TË HUAJA
DHE SHOQËRIVE PUBLIKE “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË
PERIUDHËN KORRIK-SHTATOR 2017”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Departamentit të Auditimit të IT dhe Projekteve me Financime të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016, “*Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*”, nga ku rezultoi se:

Në 5 subjekte të audituara, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 127 masa, nga të cilat janë pranuar 127 masa ose 100%, janë zbatuar plotësisht 40 prej tyre, ose 32 %, janë në proces zbatimi 40 masa, ose 32 %, janë zbatuar pjesërisht 18 ose 14% dhe nuk janë zbatuar 29 masa ose 22%.

Të analizuar sipas llojit të masave të rekomanduara, zbatimi i tyre rezulton:

a-Masa organizative, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 68 masa, nga të cilat janë pranuar 68 masa ose 100%, janë zbatuar plotësisht 15 prej tyre, ose 22 %, janë në proces zbatimi 29 masa ose 43%, janë zbatuar pjesërisht 8 prej tyre ose 12% dhe nuk janë zbatuar 16 masa ose 23%.

b-Masa për shpërblim dëmi, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **21** masa, për vlerën **2,323,937** mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **21** masa në vlerë **2,323,937** mijë lekë ose **100 %**, janë zbatuar plotësisht **1** prej tyre në vlerë **7,034** mijë lekë ose në masën **5 %**, janë në proces zbatimi **7** masa në vlerë **221,450** mijë lekë ose **33 %**, janë zbatuar pjesërisht **8** masa në vlerë **2,033,265** mijë lekë ose **38%** dhe nuk janë zbatuar **5** masa në vlerë **62,188** mijë lekë ose në masën **24%**.

c-Masa për shpenzime/të ardhura jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **8** masa, për vlerën **339,564** mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **8** masa në vlerë **339,564** mijë lekë ose **100%**, janë zbatuar plotësisht **1** prej tyre në vlerë **12,341** mijë lekë ose në masën **12%**, janë në proces zbatimi **3** masa në vlerë **315,335** mijë lekë ose **38%**, është zbatuar pjesërisht **0** masë dhe nuk janë zbatuar **4** masa në vlerë **11,888** lekë ose në masën **50%**.

d-Masa administrative, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **2** masa, nga të cilat janë pranuar **2** masa ose **100%**, nga të cilat, **1** masë nuk është zbatuar ose në masën **50 %** dhe **1** masë është zbatuar pjesërisht ose në masën **50%**.

e-Masa disiplinore, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **28** masa, nga të cilat janë pranuar **28** masa ose **100%**, janë zbatuar plotësisht **23** prej tyre, ose në masën **83 %**, janë zbatuar pjesërisht **2** masa ose **7%** dhe nuk janë zbatuar **3** masa ose në masën **10 %**.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në periudhën Korrik-Shtator 2017”.

II. Të rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

1. SPITALI RAJONAL VLORË

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Spitali Rajonal, me shkresën nr. 434/10, datë 06.10.2017, rezultoi se Spitali Rajonal Vlorë nuk ka zbatuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Spitali Rajonal Vlorë i ka trajtuar rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 16 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 1 masë, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 8 masa dhe nuk janë zbatuar 5 masa.

-Janë rekomanduar 2 masa për shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 0 masa dhe janë në proces realizimi 0 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa.

-Janë rekomanduar 4 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 0 masa dhe janë në proces realizimi 0 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa.

-Janë rekomanduar 10 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 10 masa.

Për sa më sipër rikërkojmë që Spitali Rajonal Vlorë të marrë masa të zbatojë të gjitha rekomandimet që rezultuan të pa zbatuara në përputhje me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 20 ditëve, duke njoftuar mbi ecurinë e

zbatimit të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje: Nga auditimi i aktiveve të dala jashtë përdorimit është konstatuar se në 1 rast (për pajisjet hotelerike me vlerë 4,235,742 lekë) relacioni i hartuar nga grupi i punës së Spitalit Rajonal për vlerësimin e aseteve me përbërje metalike në sasinë 767 kg nuk është kryer i saktë. Ky relacion nuk përmban të dhëna të sakta mbi procedurën e mbajtur për vlerësimin e këtij grupi asetesh, nuk jepën të dhëna për mënyrën e identifikimit, peshimit dhe nuk paraqitet efekti ekonomik i masave për riaftësim. Gjithashtu, procedura e shitjes për skrap nuk është e rregullt pasi nuk janë paraqitur minimalisht tre ofertues për shitjen e materialeve për skrap, si dhe operatori i vetëm fitues nuk ka paraqitur ofertë pranë Spitalit Rajonal Vlorë

-I gjithë identifikimi, vlerësimi dhe raportimi i aktiveve të cilat do të dalin jashtë përdorimi, kryhet çdo fillim viti por raportohet dhe shënohet në të dhënat e magazinës për çdo llogari në periudhën e vitit paraardhës dhe jo në momentin e daljes reale jashtë përdorimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 të Ministrisë së Financave datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, Pika 406, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 për Ankandin Publik, Neni 4 “Fusha e Zbatimit”, Pika 1.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, sektori i financës, si dhe nga grupi i punës i cili ngrihet në çdo rast për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të merren masa për hartimin e detajuar të relacioneve me të dhëna të sakta informuese dhe justifikuese për plotësimin e kushteve tekniko-ekonomike.

-Nga Drejtoria e Spitalit të merren masa që të eliminohen praktikatat formale të realizimit të daljeve jashtë përdorimi të cilat bien në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 të Ministrisë së Financave.

-Nga Sektori i Financës të merren masa që çdo ngjarje kontabël të regjistrohet dhe të raportohet në momentin real të ndodhjes.

Menjëherë

2.Gjetje: Nga auditimi i inventarëve ekonomik, është konstatuar një rast për magazinën e farmacisë ku vlera e raportuar kontabël në fund të vitit nuk përputhet në tërësi me vlerën fizike, sepse nuk janë pasqyruar dhe dokumentuar lëvizjet e këtyre inventarëve në magazinat përkatëse.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2015 janë konstatuar parregullsi në mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit ku informacioni i paraqitur në seksionin “Pakësime” nuk reflekton të ndarë gjendjen e materialeve të dala jashtë përdorimi për këto llogari nga gjendja e materialeve të cilat janë qarkulluar por të cilat janë asete të Spitalit Rajonal. Pasaktësia e reflektuar krijon konfuzion në kuptimin e pasqyrave financiare dhe veprimi është në kundërshtim me standardet e raportimit kombëtar kontabël.

-Për aktivet të cilat janë aktualisht në përdorim të Spitalit Rajonal Vlorë nuk ekziston regjistri fizik i aktiveve por vetëm gjendja e tyre kontabile. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr 30, kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes tyre”, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Financës si dhe magazinierët përgjegjës, të merren masa që të kryhet regjistrimi i plotë i gjendjes kontabile në mënyrë që të përputhet me gjendjen fizike plus gjendjen e

aktiveve në përdorim ose aktivet të cilat dalin në përdorim të regjistohen si hyrje në magazinën përkatëse përgjegjëse dhe përdoruese të këtyre aktiveve.

-Nga sektori i financës të merren masa që të identifikohen dhe të pasqyrohen saktësisht vlerat e aktiveve të cilat janë në përdorim dhe të jepen sqarime të hollësishme për çdo pasaktësi në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të raportuara duke rritur nivelin e kuptueshmërisë së këtyre pasqyrave.

-Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, sektori i financës dhe sektori juridik të merren masa dhe të hartohet regjistri i aktiveve sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë

3.Gjetje: Këshilli Tekniko-Administrativ dhe Komisioni për Menaxhimin e Riskut ka marrë vendime të cilat nuk janë në kompetencë të funksioneve dhe detyrave të specifikuara në Rregulloren e brendshme të Spitalit Rajonal Vlorë

-Komisioni për Menaxhimin e Riskut por nuk ka hartuar planin e veprimit për minimizimin e risqeve të rëndësisë së lartë brenda muajit mars të çdo viti si dhe monitorimin në vazhdimësi të tyre duke mos përmbushur një nga katër detyrat dhe përgjegjësitë që ky komision ka.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal të merren masa për të ngritur një sistem të mirëfilltë dhe efikas për monitorimin tekniko- administrativ, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete brenda kompetencave të Këshillit Tekniko-Administrativ/Komisionit për Menaxhimin e Riskut të përshkruara në Rregulloren e Spitalit, ose të përcaktohen detyra të reja për të cilat Këshilli/Komisioni të ketë kompetencë.

-Komisioni për Menaxhimin e Riskut të hartojë planin e veprimit për minimizimin e riskut të rëndësisë së lartë brenda tremujorit të parë të vitit si dhe të kryejë monitorimin në vazhdimësi të tyre duke hartuar politika të qarta menaxhimi.

Menjëherë

4.Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave janë konstatuar 18 raste të personave të punësuar rishtazi në vitin 2016 si mjekë vullnetarë dhe 34 raste punësimi me kontratë në periudhën 2014-2015, ku për procedurën e marrjes në punë nuk figuron miratimi i Ministrit.

-Gjithashtu nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve janë konstatuar mangësi në procedurën e përzgjedhjes së aplikantëve pasi, krahas mungesës së aprovimit të Ministrit, mungon vlerësimi nga komisioni ad-hoc.

-Janë konstatuar diferenca midis pagave të përgjithshme bruto të deklaruara në listë pagesë dhe pagave të deklaruara në sistemin tatimor.

-Në listë pagesat e Spitalit Rajonal Vlorë nuk shënohen vitet e punës në numër por vetëm në vlerë, ka ndryshime të mënyrës së llogaritjes së vjetërsisë për të njëjtin person në listë pagesa të ndryshme edhe pse brenda një periudhë një vjeçare.

-Nuk përputhet emërimi real me pozicionin në listë pagesë dhe me pozicionin në sistemin tatimor, nuk jepen të dhëna për arsimimin duke vështirësuar punën për llogaritjen e pagës së grupit.

-Nuk është bërë azhurnimi i librezave të punës sipas emërimeve, lëvizjeve të brendshme dhe sipas viteve specifike të punësimit. I gjithë konfuzioni i krijuar në komponentët e pagës ka ndikuar në ndryshimin e niveleve të pagave, duke sjellë diferenca pozitive dhe negative.

-Diferencat negative nënkuptojnë se personat e identifikuar janë paguar më shumë se çfarë u takon për pozicionin që mbajnë, ndërsa diferencat pozitive tregojnë se personat e identifikuar

janë paguar më pak se emërimi përkatës ose pozicioni i tyre real nuk është pozicioni i shënuar në listë pagesë.

-Diferencat e raportuara nga Spitali Rajonal Vlorë janë në shumën 2,010,135.84 lekë dhe çështja është raportuar penalisht pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin. Nr 506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore, Vendimin nr. 610, datë 24.7.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave“, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, Lidhja nr. II dhe VKM nr. 527, datë 16.08.2012, Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”.

Për këtë rekomandojmë:

Në çdo rast, të merren masa që marrja në punë e punonjësve të bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrencës dhe kriterëve të përcaktuara të vlerësimit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, duke ndjekur etapat e duhura deri në shpalljen fitues të konkurrentit.

-Nga Departamenti i Financës dhe ekonomisti i pagave të Spitalit Rajonal Vlorë, të merren masa që të **ri-strukturohet** mënyra e përlllogaritjes së pagave **për çdo të punësuar** në Spitalin Rajonal Vlorë duke rritur transparencën në afrimin e informacionit përkatës për të gjithë komponentët e pagës, duke shënuar vitet e punës në numër dhe në vlerë, pozicionin e punës sipas emërimit përkatës të gjithsecilit, pagën e grupit sipas arsimimit përkatës të gjithsecilit, mënyrën e llogaritjes së orëve shtesë dhe të gjitha shtesave dhe ndalesave të cilat duhet të paraqiten në listë pagesë, duke qenë në përputhshmëri të plotë edhe me deklarinimin e listë pagesave në sistemin tatimor të Republikës së Shqipërisë.

-Të merren masa që të bëhet azhurnimi i regjistrit të punonjësve si dhe librezave të punës me lëvizjet përkatëse dhe periudhat përkatëse për çdo të punësuar si edhe plotësimi i dosjeve për çdo të punësuar sipas inventarit të dosjes.

Menjëherë

5.Gjetje: Nga auditimi i gjendjeve debitore-kreditore janë konstatuar pasaktësi në 7 raste në identifikimin e debitit real të prapambetur të krijuar në vitet 2006-2014 nga lidhja e kontratave të shërbimeve/mallrave dhe debitit të raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2015 dhe 2016. Ky veprim ka ndikuar në raportime të gabuara kundrejt Ministrisë së Shëndetësisë në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5 të Ministrisë së Financave datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, duke ndikuar në pasqyrim të pasaktë të vlerës së debitorëve në pasqyrën e pozicionit financiar.

Për këtë rekomandojmë:

Nga sektori i financës, të merren masa që të kryhet llogaritja e saktë e detyrimeve të prapambetura të Spitalit Rajonal Vlorë si dhe të pasqyrohen vlerat e sakta të gjendjeve debitore-kreditore në pasqyrën e pozicionit financiar.

Menjëherë

6.Gjetje: Nga auditimi i gjendjeve debitore rezulton se institucioni nuk ka politika të qarta për arkëtimin e detyrimeve dhe menaxhimin e debitorëve me vlerë totale debiti 7,587,764 lekë për vitin 2016, nuk zotëron informacion për adresat e banimit të katër debitorëve me vlerë detyrimi 458,580 lekë dhe nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar ndër vite nga masat e lëna rekomandim nga KLSH apo probleme administrative të krijuara në institucion. Këto veprime janë në mospërputhje me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, Sektori i Financës dhe juristi i shoqërisë, të analizohet situata e debitorëve, nga ku të dalin përfundime për zgjidhjen e situatave të ndryshme të krijuara, dhe të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve deri në adresimin në organet gjyqësore nëse do të jetë e nevojshme, pavarësisht nga vlera.

Menjëherë

7.Gjetje: Nga auditimi i gjendjeve kreditore, konstatohet se Spitali Rajonal Vlorë ka lidhur 4 kontrata për energjinë elektrike dhe në sistemin e OSHEE për 3 prej tyre figurojnë detyrime të papaguara dhe kamatëvonesa për periudhën 2012-2015 në vlerën 422,668 lekë. Në shkurt 2016 është kryer një akt- rakordim mes OSHEE dhe Spitalit Rajonal Vlorë për detyrimet e kësaj të fundit ndaj operatorit furnizues të energjisë elektrike ku vlera e detyrimeve sipas akt-rakordimit paraqitet në zero. Ky akt-rakordim nuk është i saktë pasi në sistemin online të OSHEE figurojnë detyrimet e pashlyera dhe kamat-vonesat e aplikuar për çdo kontratë, dhe detyrimi nuk është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2016.

Për këtë rekomandojmë:

Nga sektori juridik i Spitalit Rajonal Vlorë të merren masa që të kryhet regjistrimi në sistemin online të OSHEE për të siguruar transparencë dhe saktësi në kohë reale për detyrimet e Spitalit ndaj operatorit furnizues të energjisë elektrike si dhe të kryhet raportimi çdo muaj me sektorin e financës për reflektimin e detyrimeve në kohë reale.

-Nga sektori i financës të merren masa që të identifikohen dhe të raportohen saktë dhe në kohë të gjitha detyrimet kontraktuale qofshin këto të përhershme apo të përkohshme për të shmangur penalitetet që rrjedhin nga mosrespektimi i tyre dhe uljen e kostove shtesë.

Menjëherë

8.Gjetje: Nga auditimi i gjendjes së furnitorëve, janë identifikuar operatorë ekonomikë që janë klasifikuar gabimisht si “Furnitorë”, por duhet të ishin klasifikuar si “Debitorë” pasi kanë detyrim ndaj Spitalit vlerën totale prej 385,258 lekë në vitin 2016. Gjithashtu edhe identifikimi i këtyre debitorëve është kryer me vonesë pasi është pasqyruar vetëm në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe jo në pasqyrat e vitit paraardhës, edhe pse debiti i tyre është krijuar duke filluar që nga viti 2006. Këto veprime janë në kundërshtim me standardet e raportimit kombëtar kontabël si dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Për këtë rekomandojmë:

Nga sektori i financës, të merren masa që të bëhet identifikimi dhe raportimi i saktë i detyrimeve të krijuara sipas standardeve kombëtare kontabël dhe në përputhje me politikat kontabël të miratuara nga vetë institucioni.

Menjëherë

9.Gjetje:Për periudhën objekt auditimi, dosjet e prokurimit (01.01.2013 deri më 30.03.2017) nuk janë të inventarizuara e nënshkruar nga Njësia e Prokurimit dhe nuk janë arkivuar, veprime në kundërshtim me nenin 13 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, të ngrihet grup pune, në përbërje të të cilit të jenë anëtarët e Njesisë së Prokurimit, me qëllim kryerjen e inventarizimit të dosjeve të prokurimit dhe të dorëzohen në arkivin e SRV në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2013.

Menjëherë

10.Gjetje: Për periudhën objekt auditimi, nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83, pika 2.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitali Rajonal Vlorë, të merren masa për planifikimin dhe kryerjen e trajnimit për punonjësit pjesëmarrës në zhvillimin e procedurave të prokurimit, në përputhje me VKM nr. 914 dhe udhëzimeve të APP, me qëllim rritjen e kapaciteteve të nëpunësve që marrin pjesë në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Menjëherë

11.Gjetje: Në të gjitha praktikat e procedurave të prokurimit të audituara, studimi i vlerës së kontratës është llogaritur duke u mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike.

-Në të gjitha procedurat e prokurimeve të audituara nuk konstatohet të jetë argumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim.

-Nuk është bërë ndarja e detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të zyrtarëve të përfshirë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesit

-Në njësinë e prokurimit është emëruar një punonjës me arsim të mesëm.

-Në të gjitha rastet e audituara, në procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar arsyen e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, pika 2/ç si dhe kreu V, pika 2, germa a, pika 1, kreu IV, pika 5, germa “c” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratës”.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitali Rajonal Vlorë, të merren masa që në zhvillimin e procedurave të prokurimit, për llogaritja e fondit limit të kontratave të bëhet në përputhje me nenin 59 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke konsideruar në raste të veçanta çmimet e përcaktuara në manualët korrente të çmimeve.

-Nga Njësia e Prokurimit në DT vendosja e kriterëve të kualifikimit të argumentohet dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

-Nga titullari i autoritetit kontraktor të bëhet ndarje e detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të zyrtarëve të përfshirë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesit në mënyrë që të dalin përgjegjësitë individuale gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit si dhe të emërohen punonjës me arsim të lartë në zbatim të legjislacionit në fuqi.

-Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në çdo rast të dokumentojë dhe argumentojë gjatë realizimit të procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje mënyrën dhe arsyen e përzgjedhjes të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

Menjëherë

12.Gjetje: Në dy raste: “Rikonstruksion i disa nyjeve hidrosanitare të Spitalit Rajonal Vlorë” me vlerë fondi limit 11,891,950 lekë pa tvsh të zhvilluar në Gusht 2015 dhe “Rikonstruksion i Godinës së Reanimacionit të Peditrisë në Spitalit Rajonal Vlorë”, me vlerë fondi limit 13,642,796.40 lekë pa tvsh të zhvilluar në Tetor 2016 u konstatua që ishte përzgjedhur Kryetar i KVO^{-së}, në kundërshtim të hapur me nenin 58 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik.”, për arsye se nuk është zyrtar i lartë drejtues në Spitalin Rajonal Vlorë.

-Nga auditimi u konstatua që nga titullari i Autoriteti Kontraktor janë nënshkruar marrëveshje nënkontraktimi në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar

-Nga auditimi u konstatua që janë vendosur kritere në DT, që nuk janë të domosdoshme për realizimin e punimeve të prokuruar që dekonspiron pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik e janë në kundërshti me pikën 4, neni 22 “Format e komunikimit” , Kreu II, Rregullat e përgjithshme të prokurimit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

-Në zbatimin e kontratave të lidhura për vitin 2015, u konstatua se në zbatimin e punimeve civile të tenderit me objekt “Rikonstruksion i disa nyjeve sanitare të Spitalit Rajonal Vlorë” nga Autoriteti Kontraktor nuk janë bërë monitorime sipas kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për monitorimin e jashtëm (që kryhet përmes vizitave, ose intervistimit) përgjatë, ose pas përfundimit të kontratës.

Për këtë rekomandojmë:

Të merren masa nga titullari i Autoritetit Kontraktor që për të gjitha procedurat e prokurimeve që do të zhvillohen, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të përzgjidhet një nga zyrtarët e lartë të SR Vlorë dhe miratimi i nënkontraktorëve të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Nga Njësia e Prokurimit, në vijim të marrë masa që në DT vendosja e kërkesave për kualifikim të sigurojë realizimin e kontratës, konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

-Nga Drejtoria e spitalit të merren masa për monitorimin e jashtëm/vizitat në terren duke ofruar të gjithë informacionin/ dokumentacionin e nevojshëm. Gjatë kryerjes së monitorimit të jashtëm, AK mund të ndihmohet nga Mbikëqyrësi i Zbatimit të Punimeve. Sidoqoftë, në çdo rast, mbikëqyrësi do të përfshihet në monitorimin e kantatave gjatë zbatimit të tyre.

Menjëherë

13.Gjetje: Në të gjitha rastet e zbatimit të kontratave dhe lëvrimin të mallrave janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim, por nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratave dhe kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 92, datë 29.12.2011, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, lista e proceseve të punës për prokurimet me vlerë të lartë, , UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit, të merren masa, që në zbatim të kontratave fituese të ngrihet komisioni me specialistë të fushës dhe të mbahen procesverbale për marrjen në dorëzim të mallrave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore.

Menjëherë

14.Gjetje: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi lavanterisë dhe furnizimin me inventar të butë”, zhvilluar në vitin 2016, nga Autoriteti Kontraktor nuk është argumentuar arsyeja e kryerjes së këtyre shërbimeve për periudhën 4 vjeçare, duke qenë se këto janë mallra dhe shërbime, për të cilat bëhen planifikime dhe përdorime vjetore, e që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur ose kërkesë për propozim.

Gjithashtu këto mallra/shërbime duhet të realizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76 “Kohëzgjatja e kontratë dhe me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar, pika 1.

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor nuk duhet të prokurojë mallra/punë/shërbime që duhet të zhvillohen nga organe qendrore prokurimi. Nga Njësia e Prokurimit afati kohor i zbatimit të kontratës të vendoset në përputhje me LPP e VKM nr.914.

Menjëherë

15.Gjetje: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të zhvilluar në vitin 2016 dhe 2017 “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Rajonal Vlorë” është konstatuar se operatori ekonomik i kualifikuar e shpallur fitues “F...” sh.p.k, nuk disponon licencë për “evadim mbetjesh urbane”, nuk është i regjistruar në QKR për ushtrimin e këtij aktiviteti si dhe nuk ka në pronësi apo marrë me qira një makineri sipas dokumenteve të tenderit. Shpallja fitues e përsëritur e këtij operatori ngarkon me përgjegjësi KVO për kualifikimin dhe titullarin e autoritetit kontraktor, veprimet apo mosveprimet e të cilëve janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për këtë rekomandojmë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente;

-Nga Drejtoria e Spitalit t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt.

Menjëherë

16.Gjetje. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Spitalin Rajonal Vlorë është ushtruar auditim në zbatim të Programit të auditimit me nr. 962/1 datë 20.10.2015, të miratuar nga Kryetari i KLSH, ku në përfundim të tij, janë përcjell rekomandimet dhe rezultatet e auditimit.

Me shkresën nr. 962/12, datë 15.02.2016 në SRV është kryer auditim mbi zbatimin e rekomandimeve, nga ku ka rezultuar se nga 14 masa organizative janë zbatuar plotësisht 7, janë zbatuar pjesërisht 5 dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

Janë rekomanduar 6 masa për shpërblim dëmi, nga të cilat 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 3 masa nuk janë zbatuar.

Aktualisht zbatimi i rekomandimeve të lëna është si më poshtë:

-Nga 14 masa organizative janë zbatuar plotësisht 8 masa, janë realizuar pjesërisht 5 masa dhe 1 masë nuk është zbatuar.

-Janë rekomanduar 6 masa për shpërblim dëmi në shumën 3,558,770 lekë, tre masa janë realizuar pjesërisht në shumën 449,635 lekë ose në masën 12.6% lekë dhe tre nuk janë zbatuar.

A. Masat e realizuara pjesërisht janë:

a. Për dëmshpërblimin e vlerës 1,698,358 lekë nga 13 punonjës, është konstatuar se vlera e shlyer është 240,665 lekë, ose në masën 14%.

b. Për dëmshpërblimin e vlerës totale prej 110,680 lekë, nga operatori ekonomik “Sh” shpk është paguar vlere 76,346 lekë dhe 34,334 lekë nga operatori ekonomik “P” shpk nuk është paguar.

c. Për dëmshpërblimin e vlerës totale prej 197,644 lekë, nga operatorët ekonomik “B...”, “F...”, e “B...” shpk është paguar vlera 132,624 lekë dhe vlera prej 65,020 lekë nga operatori ekonomik “A...” e “K...” shpk nuk është paguar.

B. Masat për shpërblim dëmi që nuk janë zbatuar në vlerën totale 1,552,088 lekë janë:

a. Për dëmshpërblimin e vlerës prej 118,255 lekë (respektivisht 56,964 lekë nga z. S. D dhe 61,291 lekë nga znj. A.T), nga ana e Spitalit Rajonal nuk janë ndjekur procedura të mëtejshme për vjeljen e këtij detyrimi.

b. Për dëmshpërblimin e vlerës 1,112,000 lekë (respektivisht në vlerat 408,333 lekë për z. A... dhe 703,667 lekë për z. A.A) nga ana e Spitalit Rajonal nuk janë ndjekur procedura të mëtejshme për vjeljen e këtij detyrimi.

c. Për dëmshpërblimin e vlerës prej 321,833 lekë nga operatori ekonomik “B” shpk, nga ana e Spitalit Rajonal nuk janë ndjekur procedura të mëtejshme për vjeljen e këtij detyrimi.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Spitali Rajonal Vlorë të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore. Të merren masa të menjëhershme për rikuperimin e vlerës dëm ekonomik nga KLSH në auditivet e mëparshme.

-Në rast mos-zbatimi të rekomandimeve të KLSH do të raportojë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave të ligjshme të Spitalit Rajonal Vlorë dhe të Buxhetit të Shtetit

Menjëherë

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Spitali Rajonal Vlorë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me **vlerën 3,031,674 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1.Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar në vitin 2016 dhe 2017 “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Rajonal Vlorë” me fitues operatorin ekonomik “F” është konstatuar se procesi i klorifikimit i specifikuar në kontratë nuk kryhet. Vlera totale e **dëmit ekonomik** për këtë kontratë shërbimi është **1,687,608 lekë me tvsh** (respektivisht në shumën 1,160,827 lekë për vitin 2016 dhe 526,781 lekë për vitin 2017). Ndërkohë dëmi i pritshëm i zbatimit të kontratës nëse procesi i klorifikimit nuk do vazhdojë të kryhet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë është në vlerën 593,784 lekë pa tvsh.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit, Drejtoria e Financës të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,687,608 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik “F...” shpk, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Rajonal Vlorë”.

Menjëherë

2.Gjetje: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i sistemit të gazrave të Spitalit Rajonal Vlorë” zhvilluara në Tetor 2016, **janë përfituar 1,334,066.60 lekë.**

Kjo vlerë përbëhet nga përfshirja e TVSH-së në vlerën 1,216,666.60 lekë për pajisje në preventivin e punimeve të ndërtimit dhe prej vlerës 127,400 lekë si rrjedhojë e përfshirjes dy herë të zërit; “FV. Alarmi qendre” në projekt-preventiv. Vlera prej **1,344,066.60 lekë përbën**

dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. Veprimi i mësipërm ngarkon me përgjegjësi hartuesin e projekt preventivitetit "A...." shpk.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, Drejtoria e Financës të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,344,066.60 lekë me tvsh**, nga operatori ekonomik "A...." sh.p.k,

për shkeljet e konstatuara në përlogaritjen e vlerës së kontratës në prokurimin me objekt : Rikonstruksion i sistemit të gazrave të Spitalit Rajonal Vlorë".

Menjëherë

C. SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT

1.Gjetje: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i disa nyjeve sanitare në Spitalit Rajonal Vlorë" zhvilluar në Gusht 2015, është kualifikuar dhe shpallur fitues bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomik "B...." shpk dhe "P..." shpk. Duke qenë se të gjithë ofertuesit nuk plotësonin kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor duhej të ishin s'kualifikuar, si pasojë duhej të ishte anuluar tenderi dhe të fillohej procedurë e re. Kualifikimi dhe shpallja fitues i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik "B..." shpk dhe "P...." shpk bie ndesh me nenet 1,2 e 20 të ligjit nr.9463, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publikë" të ndryshuar e ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave. Shuma **4,238,559.20 lekë me tvsh** që është diferenca midis ofertës të bashkimit të përkohshëm operatorëve ekonomik "B...." shpk shpallur padrejtësisht fitues me ofertën e operatorit ekonomik "V..." shpk të s'kualifikuar është efekti ekonomik i shkaktuar nga shkeljet e konstatuara.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i autoritetit kontraktor të shqyrtojë vlerën 4,238,599.20 lekë me tvsh dhe të eliminojë vendosjen e kushteve diskriminuese në DT që pengojnë përmbushjen me sukses të kontratave.

-Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Rajonal Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Menjëherë

2.Gjetje. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i godinës së reanimacionit të pediatrikë në Spitalin Rajonal Vlorë" zhvilluar në Tetor 2016, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik "C..." shpk. Duke qenë se të gjithë ofertuesit nuk plotësonin kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor duhej të ishin s'kualifikuar, si pasojë duhej të ishte anuluar tenderi dhe të fillohej procedurë e re.

Kualifikimi dhe shpallja fitues i operatorit ekonomik "C...." shpk bie ndesh me nenet 1,2 e 20 të ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar e ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave. Shuma **4,634,655.96 lekë me tvsh** që është diferenca midis ofertës operatorit ekonomik "C....." shpk shpallur padrejtësisht fitues me ofertën e operatorit ekonomik "S...." shpk të s'kualifikuar është **efekti ekonomik negativ** i shkaktuar nga shkeljet e konstatuara.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i autoritetit kontraktor të shqyrtojë vlerën 4,634,655.96 lekë me tvsh dhe të eliminojë vendosjen e kushteve diskriminuese në DT që pengojnë përmbushjen me sukses të kontratave.

-Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Rajonal Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Menjëherë

3.Gjetje: Nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Spitali Rajonal Vlorë është paditur nga 25 persona, nga të cilat 17 janë në proces gjykimi për të cilët pretendohet një dëmshpërblim në vlerë totale 6,759,813 lekë fituar në shkallën e parë të gjykimit, me një efekt negative financiar të pritshëm, ndërsa 8 çështje janë përfunduar duke e detyruar Spitalin Rajonal Vlorë të paguajë vlerën **2,743,527 lekë**, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë të merren masa për shqyrtimin e efektit financiar në vlerën 2,743,527 lekë, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit për shmangien e kostove shtese nga proceset gjyqësore në proces të cilat janë probabël për efekt negative financiar në vlerën 6,759,813 lekë për Spitalin Rajonal Vlorë.

Nga Drejtoria e Spitalit dhe Këshilli Administrativ, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

4.Gjetje: Nga verifikimi i deklarimeve në sistemin tatimor janë konstatuar vonesa në deklarin e punonjësve të marrë në punë ose të larguar për të cilat nuk janë respektuar afatet e deklaramit dhe për këto veprime të janë aplikuar gjoba në sistem. Vlera e tyre prej **260,000 lekë** përbën **efekt negativ financiar**.

-Gjithashtu në sistemin tatimor janë hasur mospërputhshmëri mes titullit të emërimit dhe pozicionit të personit dhe në rastin e mjekëve vullnetarë regjistrimi i tyre është kryer 1 muaj me vonesë. Prandaj, ndalesat e sigurimeve shoqërore për këta mjek të cilat nuk pasqyrohen në sistemin tatimor janë **11,682 lekë** dhe përbën **efekt negativ financiar**.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Financës të merren masa që deklarimi në sistemin tatimor të kryhet në kohë reale, në përputhje me datën e emërimit të personit, pozicionin e saktë të emëruar dhe sipas legjislacionit fiskal në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

D. TË TJERA

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e rradhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

2.OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, nr.272/16, datë 27/09/2017, rezultoi se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA ka hartuar programin dhe ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga data e njoftimit të raportit të përfundimtar të auditimit.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 13 masa organizative nga të cilat, 6 masa janë zbatuar plotësisht , 1 masë është zbatuar pjesërisht , 6 masa janë në proces zbatimi.

-Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht , 7 masa janë zbatuar pjesërisht , 1 masë është në proces zbatimi.

-Është rekomanduar 1 masë për eliminimin e efekteve negative financiare, nga të cilat, 1 masë është zbatuar pjesërisht.

-Janë rekomanduar 13 masa disiplinore nga të cilat, 10 masa janë zbatuar plotësisht dhe nuk janë zbatuar 3 masa disiplinore.

A.MASA ORGANIZATIVE

I. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, përgjithësisht i kanë trajtuar me korrektesë rekomandimet e KLSH-së, dërguara me shkresën nr. 495/20 prot,datë 24.09.2015, por nuk kanë marrë plotësisht masa për zbatimin e tyre.

1.1 Rekomandimi:

-Nga Shoqëria “OSHEE” Sh.a të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore. Të merren masa të menjëhershme për rikuperimin e vlerës së konsideruar dëm ekonomik nga KLSH në auditimet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të përfshirë në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, auditimin e aktivitetit të të gjitha kompanive të mbledhjes së borxhit të keq të energjisë elektrike, dhe për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tyre, të informohet Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë.Gjithashtu, nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të kryhet auditim i plotë i veprimtarisë administruese dhe menaxhuese, ekonomike dhe financiare të ish-CEZ Shpërndarje Sha, në periudhën e administrimit të përkohshëm duke filluar nga data 21.01.2013, si dhe duke analizuar në veçanti kallëzimin penal të Avokaturës së Shtetit, përcjellë organit të Prokurorisë me shkresën nr. 526/34, datë 24.07.2013, për arsye se KLSH nuk mund të auditojë këtë ish- shoqëri për vet statusin privat të saj.

Menjëherë

1.3 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të përfshirë në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, auditimin e 13.059 rasteve të konstatuara në sistemin e faturimit (Billing), duke zbatuar procedurat audituese për problemin e konstatuar, dhe për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tyre, të informojë Këshillin Mbikëqyrës dhe Administratorin e Shoqërisë.

Menjëherë

II. Nga auditimi mbi mbajtjen e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen e bilancit dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e varësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit”, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Shoqëria “OSHEE” Sh.a nuk ka përfunduar inventarizimi fizik të aktiveve afatgjata, si dhe nuk është zbatuar plotësisht VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë nga KESH Sh.a në pronësi të Shoqërisë “OSHEE” Sh.a

1.1. Rekomandim:

Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a të merren masa tekniko-organizative dhe të ndiqen procedurat e nevojshme ligjore për;

-kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve afatgjata, si dhe zbatimin e plotë të VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Shoqërisë "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a".

-hartimin e plotë të rregullores për menaxhimin e aseteve në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Në pasqyrat financiare të shoqërisë ekziston një mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit faturimit & arkëtimit (Billing-ut) dhe të pozicionit financiar "Të arkëtueshme" (kontabilitetit) për gjendjen e klientëve më 31 dhjetor 2015. Mospërputhja midis sistemit "SAP" dhe sistemit "Billing-ut" (faturim & arkëtim) dhe kontabilitetit më 31.12.2015 arrijnë në vlerën 1,641,669 mijë lekë, kundrejt 1,318,805 mijë lekë që rezultonte kjo mospërputhje më 31.12.2014, ose me një rritje prej 322,864 mijë lekë, fakt që nuk jep siguri në funksionimin e kontrollin lidhur me të ardhurat

2.1. Rekomandim:

Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a të merren masat e nevojshme për përmirësimin e sistemit të faturimit "Billing" me kontabilitetin "SAP", për të eliminuar mospërputhjet llogarive të arkëtueshme.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Shoqëria "OSHEE" Sh.a nuk ka arritur të finalizojë rakordimin e detyrimeve të ndërsjellta me Shoqërinë "KESH" Sh.a, Shoqërinë "OST" Sh.a dhe Shoqërinë "Posta Shqiptare", në kundërshtim me urdhrin e Kryeministrit nr. 74, datë 27.05.2015 "Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për evidentimin dhe adresimin e problematikave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në sektorin e energjisë elektrike".

3.1. Rekomandim:

Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a të merren masa për përfundimin e rakordimeve të detyrime të ndërsjellta me Shoqërinë "KESH" Sh.a, Shoqërinë "OST" Sh.a dhe Shoqërinë "Posta Shqiptare".

Menjëherë

IV. Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria "D....." shpk", me objekt "Rinstruksioni i 14 linjave 35 kv", viti 2016, u konstatua se nuk është arsyetuar mosrealizimin në afatin e përcaktuar të kësaj kontrate, me një vonesë të përllongatur deri më 30.06.2017, datë në të cilën përfundoj auditimi për 6-muaj (Afati i zbatimit të punimeve për këtë kontrate është 6- muaj nga dorëzimi i sheshit 21.06-21.12.2016). Referuar nenit 37 pika 37.1 (a) penaliteti (tarifa ditore) për moszbatim kontrate është 4/1000 ose 0.004 e vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ka krijuar një penali në vlerën 69,191,252 lekë, i cili në rast mos pasje të arsye të justifikuara,

duhej llogaritur, njoftuar dhe ndalur penaltetin kontraktor. Theksojmë se punimet për realizimin e kontratës vazhdojnë

Rekomandimi:

Nga Shoqëria “OSHEE” Sh.a të shqyrtohen arsyet e mos realizimit të kontratës në afatin e përcaktuar, si dhe të merren masa të plota për vendosjen e afateve të tjera prekulzive, referuar Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Në rast se punimet nuk realizohen në afatin e rivendosur, të llogariten penaltetet përkatëse dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e tyre, nga shoqëria "D...." shpk.

Menjëherë

VI. Nga auditimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

OSHEE ka marrëveshje me 72 shoqëri gjeneruese të energjisë elektrike në juridiksionin e të cilave ndodhen 112 HECE, që janë të lidhur në rrjetin shpërndarës të OSHEE 35/10/6 KV. Nga të 112 HEC-et e lidhura në rrjetin shpërndarës, vetëm 2 HEC-e janë lidhur sipas skemës “Degëzim” me linjat ekzistuese 35kv, konkretisht HEC S... dhe HEC N....Pra të 110 HECET e tjerë, shfrytëzojnë hapësirat fizike dhe pajisjet (transformator etj) të nënstacioneve të OSHEE dhe nuk paguajnë asnjë detyrim apo tarifë. Shfrytëzimi i hapësirave fizike dhe pajisjeve (transformator etj) të nënstacioneve të OSHEE, nga 110 HECE e tjerë, të cilët nuk paguajnë asnjë detyrim apo tarifë, është në kundërshtim me Ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë”, neni 28 pika 4 “Kostot për lidhjen me rrjetin” pika 2, Vendimin e ERE nr. 166, datë 10.10.2016 të ERE “Për miratimin e rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, KAP III, pika 3.2.16, KREU IV, pika 4.15

1.1 Rekomandimi:

- Nga Shoqëria “OSHEE” Sh.a të merren masa për të hartuar marrëveshje me HECET që shfrytëzojnë hapësirat fizike dhe pajisjet (transformator etj) të nënstacioneve të OSHEE, konform dispozitave të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, për pagesën e detyrimeve përkatëse .

Menjëherë dhe në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Në përcaktimin e fondit limit (preventivi i projekt zbatimit), në objektin “Rinstruksioni i 14 linjave 35 kV, viti 2016, u konstatua se nuk provohet plotësisht rritja e distancave të linjave me 2.28 km në *vlerën 8,135,047 lekë*, konstatim referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), pasi një pjesë e dokumentacioni justifikues bazë është me mangësi.

1.1 Rekomandimi:

Nga Shoqëria “OSHEE” Sh.a të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës të pa përfshirë në projektim dhe preventivim, i cili të kryejë ekzaminimet teknike duke respektuar kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sinqertë dhe të vërtetë të distancave për çdo linjë dhe preventivin respektiv. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se nuk provohet rritja e distancave të linjës me 2.28 km në vlerën 8,135,047 lekë, referuar legjislacionit në fuqi (KTP Libri VI17.18.19- 1978, manuallet e ndërtimit dhe analizat përkatëse, si dhe projekteve respektive të çdo linje), kushteve teknike të projektimit dhe atyre të zbatimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe Standarin Evropian EN 50341 Retun, konsiderohet dëm ekonomik dhe të

kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 8,135,047 lekë** nga shoqëria "D...." shpk.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria "D...." shpk", me objekt "Rinstruksioni i 14 linjave 35 kv", viti 2016, u konstatua se kjo shoqëri pas demontimit të përcjellësve në rikonstruksionin e 14 linjave, nuk provohet plotësisht të ketë dorëzuar në magazinë sasinë e demontuar me një diferencë 31,549 kg përcjellës CU dhe 8,024 kg përcjellës ALC me vlerë **20,557,396 lekë**, konstatim referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), pasi një pjesë e dokumentacioni justifikues bazë është me mangësi .

2.1 Rekomandimi:

-Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës të pa përfshirë në projektim, preventivim, kolaudim dhe marrjen në dorëzim, i cili të kryejë ekzaminimet teknike duke respektuar kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sinqertë dhe të vërtetë të procesit të demontimit në fazën e projektimit, preventivimit, situacionit dhe dorëzimit.

-Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se procesi i demontimit nuk është kryer konform legjislacionit tekniko-juridik në fuqi, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 20,557,396 lekë** nga shoqëria "D...." shpk.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga bashkimi i operatorëve E.... sh.p.k dhe A.....sh.p.k , me objekt "Spostimi i N/stacionit 110/20 KV, Tiranë Qendër", viti 2016, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të Shoqërisë "OSHEE" Sh.a dhe Buxhetit të Shtetit në **vlerën 6,852,652 lekë**

Rekomandimi:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 6,852,652 lekë**, nga bashkimi i operatorëve E.... sh.p.k dhe A..... sh.p.k, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës së punëve civile me objekt "Spostimi i N/stacionit 110/20 KV, Tiranë Qendër, viti 2016".

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria E.... sh.p.k dhe A..... sh.p.k, me objekt "Spostimi i N/stacionit 110/20 KV, Tiranë Qendër, viti 2016", u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve dhe pjesëve elektrike, nuk është i plotë dhe i saktë për pajisjet: Xhunto për kabull XLPE 110 KV AL 1 X800 RM copë 3 për vlerën 4,320,000 lekë dhe Kabëll XLPE 20 KV CU 1x630 RM për vlerën 21,924,000 lekë. Konkretisht ka mospërputhje midis dokumentacionit të kërkuar në specifikimet teknike dhe test raportit të fabrikës për Kabëllin XLPE 20 KV CU 1x630 RM, ndërsa Xhunto për kabëll nuk janë shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar (test raport) për të provuar parametrat teknik.

-Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jep opinion e Tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmonte që këto pajisje janë njëjta me ato të

prokuruara, për të cilat bashkimi i operatorëve E... sh.p.k dhe A..... sh.p.k, ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

4.1 Rekomandimi:

Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës, i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve .Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga bashkimi i operatorëve E... sh.p.k dhe A..... sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruara, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 26,244,400 lekë** nga bashkimi i operatorëve E..... sh.p.k dhe A..... sh.p.k

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a për vitin 2015, është marrë në evidencë dhe është pasqyruar në kontabilitet zbatimi i vendimeve të ERE nr. 90 datë 15.11.2010 dhe nr. 94, datë 01.12.2010 për faturat sistemuese të "Dëmit ekonomik" dhe "Energji e pamatur, të lëshuar për periudhat 2008-2011 në **vlerën 1,763,504 mijë lekë**, duke pakësuar debinë e klientëve, në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 05.10.2015 dhe vendimit të Asamblesë së Aksionareve nr. 2765/1, datë 11.05.2016.

Përveç **vlerës 1,763,504 mijë lekë**, në kundërshtim me urdhrin e administratorit nr. 1971 prot, datë 30.01.2015, nga Dega e Shitjes dhe Drejtoria e IT janë hequr nga gjendja debitore **2920** fatura afrofe me **vlerë 148,980,422 lekë**.

-Ndryshimi i gjendjes së debisë në vlerën 1,374,946,977 lekë për llogari të Shoqërisë "OSHEE" dhe Buxhetit të Shtetit dhe TVSH vlerën 287,370,056 lekë, pa llogaritur kamatvonesën është bërë, jo nga palët Shoqëria "OSHEE", Sh.a dhe klientëve familjar, privatët dhe buxhetorët që kanë marrëdhënie kontraktuale me njëri tjetrin, por si pasojë e vendimeve të ERE. Referuar legjislacionit tatimor, ky është një problem, që ka lindur me interpretimin e ndryshimit të vlerës së transaksioneve, për furnizimin me energji elektrike klientëve referuar kontratave respektive.Meqenëse, nuk kemi të bëjmë me ndryshim të deklarimeve për 2008-2011, me inicim nga vetë tatimpaguesit (Shoqëria "OSHEE" Sh.a dhe klientëve), por nga një ent shtetëror (ERE), Shoqëria "OSHEE" Sh.a duhet ti ishte drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pas kërkesës së bërë nga ERE, e cila duhet të kishte dhënë udhëzime të hollësishme, me qëllim jo vetëm të kreditimit dhe disbursimit të TVSH, por edhe të llogaritjes së penaliteteve përkatëse. Kjo pasi korrigjimi i çdo deklarate mujore që nga viti 2008-2011, ka pasoja jo vetëm për kreditimin dhe disbursimin e TVSH, por edhe në llogaritjen e kamatvonesës. Referuar këtij fakti shoqëria "OSHEE", ka deklaruar dhe derdhur në organin tatimor më shumë TVSH të pagueshme, ndërkohë që rishikimi në ulje i saj, d.m.th, që të rritet TVSH e zbritshme e saj, ku diferenca nga TVSH e deklaruar më parë, pakëson detyrimin e TVSH së derdhur për llogari të organit tatimor dhe buxhetit të shtetit. Në termologjinë financiare referuar legjislacionit në fuqi, anulimi i faturave ka një ndikim teper negativ me rreth 15 milion euro në të ardhurat e Shoqërisë "OSHEE", Sh.a, si dhe ka një ndikim sinjifikativ në reduktimin e konsiderueshem te detyrimeve të TVSH të Shoqërisë "OSHEE", Sh.a përkundrejt Autoritetit të Tatimeve, i cili duhet të rimbursonte Shoqërinë "OSHEE" respektivisht me një vlerë të përafërt **305,997,507 lekë**, vlerë e cila nuk mund kreditohet për llogari të shoqërisë OSHEE.

Si dhe

Në termologjinë energjitike referuar legjislacionit në fuqi, anulimi i faturave ka një ndikim teper negativ ndaj Shoqërisë "Kesh" Sh.a dhe Buxhetit të Shtetit (pra është prekur bilanci energjistik), pasi një pjesë e kësaj energjie është blerë me çmim të rregulluar nga Shoqëria "Kesh" sh.a, e cila

në sasinë më të madhe e ka blerë me çmim tregu nga operatorët e tregut, sipas situatave hidrike të krijuara nga viti 2008 deri në vitin 2011, e cila nuk mund të llogaritet, pasi fatura sistemuese nr. 1487, datë 31.01.2015 është vetëm në vlerën 1,374,949 mijë lekë, pa përcaktuar sasinë, si dhe nuk është kryer identifikimi specifik (nominal) për sasinë e energjisë dhe vlerën respektive të saj. ERE në vendimet nr. 90 datë 15.11.2010 dhe nr. 94, datë 01.12.2010, ka paraqitur paqartësi madje edhe konflikt të vetë dispozitave të rregullave të tregut, të cilat nuk janë hartuar në përputhje me Ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, Ligjin, Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe kanë qenë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Rekomandimi:

-Këshilli Mbikëqyrës të rishqyrtojë pakësimin e debisë **në vlerën 1,763,504** mijë lekë, që i përket faturave sistemuese të “Dëmit ekonomik” dhe “Energji e pamatur” të lëshuar për periudhat 2008-2011 në zbatim të vendimeve të ERE nr. 90 datë 15.11.2010 dhe nr. 94, datë 01.12.2010 dhe vlerën **148,980,422** lekë që i përket faturave afrofe, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, **vlerë e cila për Shoqërinë “OSHEE” dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 30.06.2018

6. Gjetje nga auditimi:

Nga zbatimi i vendimeve të ERE nr. 148, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifor për vitin 2015” dhe vendimin nr. 128, datë 29.07.2016 “Mbi tarifën e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e lidhur në TM me matës në TU, deri më 31.05.2017, si pasojë e ankimeve që abonent të ndryshëm që kanë bërë në gjykatë, Shoqëria “OSHEE” Sh.a ka dëmshpërblyer 23 raste për **vlerën 45,907,419 lekë**. Ky dëm ekonomik ka ardhur pasi, ERE me veprimet apo mosveprimet e saj, ka krijuar një situatë konfuze në tregun e shit/blerjes së energjisë elektrike, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të Shoqërisë “OSHEE” Sh.a dhe të Buxhetit të Shtetit, fakt i provuar me shkresat si më poshtë vijon:

-Me shkresën nr. 508 prot., date 14.07.2015 të ERE-s drejtuar Administratorit të Shoqërisë OSHEE Sh.a me lëndë: Mbi ankimet e konsumatorëve të lidhur në TM për mos aplikimin e tarifave të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e lidhur në TM, sipas Vendimit nr. 148 datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

-Me shkresën nr. 6092 prot., datë 26.05.2014 Shoqëria “OSHEE” Sh.a, i kërkon ERE interpretim se cilat janë referencat për përcaktimin e çmimit të abonentëve jo familjar, ku miratimi i pikës së lidhjes është TU/TM, apo ku është instaluar marrja nga TU/TM.

ERE me shkresën nr. 475/1prot., datë 24.07.2014 ka kthyer përgjigje duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “lidhur me sa më sipër kërkuar, ju bëjmë me dije se: *tarifat do të reflektojnë sasinë e energjisë në nivelin që maten, ashtu siç është përcaktuar dhe në dispozitat II.7.4 dhe III.3 “Kodi i matjes”*.”

Pra si u përshkrua më sipër, ERE në dy shkresa mban dy qëndrime të ndryshme. Gjithashtu, këto shkresa bien në kundërshtim me :

-a. Ligjin nr. 9072, date 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar (shfuqizuar në Prill 2015), neni 51 “Matja e energjisë elektrike të furnizuar”.

-b. Kodi i Matjes, miratuar me Vendimin nr. 101, date 26.08.2008, pikat i, ii, iii.

-c. Udhëzimin ERE “Mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, i cili ka qenë në fuqi në momentin e aplikimit të disa klientëve për furnizim me energji elektrike, miratuar me vendim nr. 17, dt. 19.12.2001 të ERE, pika 1.2, 1.4, 4.4, 5.1, 7.2.

-d. Kontrata e furnizimit me energji elektrike për klientët jo familjar, miratuar me vendim ERE nr. 109 datë 21.10.2011, pikat 6.1, 6.2, 13.1, 13.2, 13.3.

Vlera 45,907,419 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “OSHEE” dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e **cila nuk mund të dëmshpërblehet**, fakt që ngarkon me përgjegjësi ERE.

6.1 Rekomandimi:

-Nga Shoqëria “OSHEE” Sh.a të prezantohet në organet drejtuese **vlera 45,907,419 lekë**, që ka të bëjë me dëmshpërblimin e abonentëve të ndryshëm, si pasojë e ankimimeve që kanë bërë në gjykatë, nga zbatimi i vendimeve të ERE nr. 148, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifor për vitin 2015” dhe nr. 128, datë 29.07.2016 “Mbi tarifën e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e lidhur në TM me matës në TU për periudhën 01.07-31. 12.2016.

Brenda datës 30.06.2018

7. Gjetje nga auditimi:

Operatorët e tregut me të cilat Shoqëria “OSHEE” Sh.a ka lidhur kontratë për blerjen energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin energjetik, nuk kanë respektuar kontratën e nënshkruar midis palëve, konkretisht përcaktimet e pikave të kontratave 1, 3, 4, 5 dhe 7, duke sjellë penalitete të pa llogaritura dhe pa mbajtura nga Shoqëria “OSHEE” Sh.a, për operatorët e tregut në një **vlerë 27,501 euro**, konkretisht kompanitë G... në vlerën 3,351 euro, E... në vlerën 19,419 euro dhe G... sh.p.k shpk në vlerën 4,731 euro: Vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “OSHEE” Sh.a sha dhe Buxhetin e Shtetit

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 27,501 euro**, nga G..... në vlerën 3,351 euro E..... në vlerën 19,419 euro dhe G..... sh.p.k shpk në vlerën 4,731 euro.

Brenda datës 30.06.2018

8. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se Shoqërisë “OSHEE” Sh.a i është shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 13,084,095 lekë**, si pasojë e mos bërjes së plotë dhe në kohë të procedurave gjyqësore në Gjykatën e Lartë për shpërblim dëmi pasuror për L. N etj. Konkretisht:

-Shkalla e parë dhe Apeli: Pranuar pjesërisht kërkesë padia me vlerë **13,084,095 lekë** shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror, lidhur me vdekjen e të ndjerit K. N. Ndaj vendimeve të gjykatave OSHEE ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me shkresën nr. 7322, datë 20.4.2016, por nuk ka kërkuar në objektin e saj dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga zyra e përmbarimit, duke kundërshtuar në këtë mënyrë veprimet përmbarimore bazuar në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ana tjetër nga OSHEE nuk administrohet asnjë dokument që vërteton se me datë 26.4.2016 sipas libër protokollit të OSHEE, rekursi është dorëzuar në protokollin e Gjykatës së Lartë. Për pasojë nga zyra e përmbarimit me datë 29.4.2016 është ekzekutuar vendimi i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, duke i dhënë mundësi palës paditëse të ekzekutoj vendimin, duke isjell Shoqërisë “OSHEE” dhe Buxhetit të Shtetit një dëm ekonomik në vlerën **13,084,095 lekë**, çka ngarkon me përgjegjësi **E.A** me detyrë drejtore e drejtorisë juridike, e cila me veprimet dhe mosveprimet e Saj, ka realizuar mospërmbarim të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “OSHEE” Sh.a dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 13,084,095 lekë, nga mos kryerja plotësisht dhe në kohën e duhur veprimeve proceduriale .

8.1 Rekomandimi:

Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a të shqyrtohet vlera 13,084,095 *lekë*, vlerë e cila ka ardhur si pasojë e mos kryerjes plotësisht dhe në kohën e duhur e veprimeve procedurale nga drejtoria juridike për shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror për L.N etj. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës për dëmshpërblim.

Brenda datës 30.06.2018

C.SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Për shpenzimet të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në të ardhurat e shoqërisë, duke sjellë një rëndim të kostove, pasi në realizimin e shpenzimeve që shoqëria duhet të kryejë nuk është zbatuar parimi i 3E-ve, Ekonomicitet, Efikasitet dhe Efiçencë.

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë ekzekutuar 288 çështje gjyqësore për zgjidhje të kontratës së punësimit (largimet nga puna), për të cilat shuma e kërkuar nga punonjësit nëpërmjet proceseve gjyqësore është në vlerën **188,060,525 lekë**, vlerë e cila ka sjellë shoqërisë efekte negative financiare

1.1 Rekomandimi:

- Nga Shoqëria "OSHEE" Sh.a të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D.MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 63, kontratave individuale të punës, pika 6, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

I. "Zgjidhje të kontratës së punësimit" për:

1. **J. S** -, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit për periudhën 01/08/2015 dhe në vazhdim.

2. **E.A**, me detyrë drejtoreshë e drejtorisë juridike për periudhën 23/09/2013 dhe në vazhdim.

II. "Kalim në një detyrë të niveli apo klase më të ulët, që paguhet më pak për një periudhë deri në 6-muj" deri në "Zgjidhje të kontratës së punësimit" për

3. **A.F**, me detyrë Drejtor Kabineti, në cilësinë e ish-drejtorit të Divizionit të Shitjes për periudhën 04/12/2014-11/10/2016.

E. TË TJERA

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e rradhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

3.OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I LINJËS SË TRANSMETIMIT 400 KV KOSOVË - SHQIPËRI”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA për projektin “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kv Kosovë - Shqipëri”, nr. 477/9, datë 26/09/2017, rezultoi se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA ka hartuar programin dhe ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga data e njoftimit të raportit të përfundimtar të auditimit.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA për projektin “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kv Kosovë - Shqipëri”, i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 11 masa organizative, nga të cilat 4 masa janë zbatuar plotësisht , 2 masa janë zbatuar pjesërisht , 5 masa janë në proces zbatimi.

-Janë rekomanduar 2 masa për shpërbllim dëmi, nga të cilat, janë në proces zbatimi 2 masa

-Është rekomanduar 1 masë për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, masë e cila nuk është zbatuar.

-Janë rekomanduar 4 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat nuk janë zbatuar 4 masa.

- Janë rekomanduar 3 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet; 3 masa disiplinore janë zbatuar.

Për sa më sipër *rikërkojmë* që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA për projektin “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kv Kosovë - Shqipëri”, të marrë masa të zbatojë të gjitha rekomandimet që rezultuan të pa zbatuara në përputhje me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 20 ditëve, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Projekti “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 KV Kosovë-Shqipëri” është ratifikuar me ligjin nr.10248, datë 11.03.2010 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfE”, projekti ishte parashikuar të përfundonte në 30 qershor 2013. Për shkak të vonesave për zhvillimin e tenderit të punimeve të projektit dhe fazës së ritenderimit është bërë i pamundur realizimi i projektit në afatin e parashikuar duke sjell domosdoshmërinë e zgjatjes së afatit të realizimit të tij. Gjatë periudhës objekt auditimi është zgjatur afati i zbatimit të projektit dy herë, konkretisht me ligjin nr. 12/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe projektit” dhe me ligjin nr. 64/2016, datë 19.6.2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe projektit”, duke e shtyrë afatin e zbatimit të tij deri në 31.12.2017 ose 3.5 vite më shume se sa ishte parashikuar në marrëveshjen fillestare.

Për këtë rekomandojmë:

OST Sh.A dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare dy palëshe.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi:

Projekti “Linja e Transmetimit 400-KV Shqipëri - Kosovë ” ka përfunduar punimet e ndërtimit për dy lotet e para (si pjesë fillestare të projektit) në datë 14.06.2016, linja është testuar dhe kolauduar dhe e marrë në dorëzim nga OST Sh.A por nuk është venë në efikasitet të plotë pasi:

- Projekti që përfshin dy vendet (Shqipëri, Kosovë) renditet ndër projektet më të rëndësishme për sistemin tonë energjetik dhe me impakt pozitiv për të gjithë rajonin e Europës Juglindore. Edhe pse është nënshkruar Marrëveshja Operacionale ndërmjet Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) në bazë të kërkesave dhe standardeve të përshkruara në Manualin Operacional të ENTSO-E, që mundëson kryerjen e të gjitha detyrave të kontrollit të operimit të sistemit dhe ruajtjen e besueshmërisë së funksionimit të Sistemeve të interkonektuara, kjo marrëveshje bëhet efektive me njohjen e KOSTT si zonë kontrolli e pavarur.

- Ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E është nënshkruar marrëveshja më datë 10.12.2015, por nuk është bërë ende efektive për shkak të mosplotësimit të kushtit të vendosur në nenin 16.1(b) e Marrëveshjes, sipas të cilit Kosova duhet të licencojë një furnizues nga Serbia që të furnizojë një pjesë të veriut të vendit në zonat e banuara nga popullsia serbe.

Në këto kushte të bllokimit të Marrëveshjes së Lidhjes ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E, dhe meqë kanë përfunduar punimet për pjesën shqiptare të interkonektorit të ri 400 KV, OST dhe KOSTT i kanë drejtuar një letër Sekretarit të Përgjithshëm të ENTSO-E si dhe Komiteteve respektive të Operimit dhe Tregut , në të cilën i bëjnë me dije për situatën e krijuar ku si pasojë e mos-njohjes së KOSTT si zonë kontrolli, ekziston risku i mos vënies në operim të interkonektorit të ri 400 KV si dhe i mos funksionimit të marrëveshjes për rregullimin sekondar ndërmjet OST dhe KOSTT. KOSTT gjithashtu rikujton se ka nënshkruar tashmë marrëveshjet e operimit me të gjitha vendet fqinje (Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi), të cilat përcaktojnë qartë kufijtë e zonës / bllokut të kontrollit të KOSTT me vendet fqinje.

Gjithashtu i është kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm dhe strukturave të menaxhimit të ENTSO-E për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të adresuar këtë çështje dhe për të zbatuar detyrimet kontraktuale sipas marrëveshjes së interkoneksionit dhe Lidhjes së Marrëveshjes me ENTSO-E. Në këtë kontekst, KOSTT dhe OST i kanë kërkuar ENTSO që të bëjnë Amendimin e Marrëveshjes së Lidhjes duke hequr kushtin jo-teknik të vendosur në nenin 16.1 (b) që pengon fillimin e funksionimit të KOSTT si bllok kontrolli dhe të mundësojnë KOSTT-in të kryejë detyrimet ligjore. Meqë Marrëveshja e Lidhjes ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E nuk ka hyrë në fuqi, Marrëveshje Kornizë nuk mund të zbatohet plotësisht.

Për këtë rekomandojmë :

OST në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës të marrë masat për të vënë në dijeni Parlamentin dhe Qeverinë lidhur me:

- Impaktin negativ nga mos vënia në punë e projektit të përfunduar.

-Rrezikun e dështimit në rast se, nuk zgjidhet problemi i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në ENTSO-E.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi :

Në bazë të detyrimeve të marrëveshjes së huasë huamarrësi duhet të shlyej huanë në 18 këste gjashtë mujore në datat 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, duke filluar nga 30 qershori i viti 2016 deri në 30 qershor të viti 2024, në transhe të barabarta prej 2,333,333 Euro.

Nga auditimi rezulton se deri në fund të periudhës objekt auditimi janë kryer 2 pagesa (këste) për

shlyerjen e principalit në shumën 4,666,666 Euro dhe 6 pagesa (këste) për shlyerjen e interesit të huasë në shumën 1,466,556 Euro. Gjithashtu konstatohet se pagesat e 6-mujorit të dytë të vitit 2016 janë kryer jashtë afatit të parashikuar, rreth tre muaj me vonesë, por pa efekte financiare në kundërshtim me pikës 5.1 të Marrëveshjes së Huasë.

Për këtë rekomandojmë:

OST Sh.A, PIU dhe DE të marrin masa që të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e huave brenda afateve të përcaktuara, pasi mos pagesa në kohë sjell akumulim të detyrimeve duke rënduar situatën financiare të shoqërisë por edhe prishje imazhi dhe besueshmërie tek donatorët.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Për shërbimin e konsulencës dhe mbikqyrjes është lidhur kontrata datë 24.09.2009 midis M....., OST Sh.A dhe K.... Sh.A, me afat 33 muaj.Nga auditimi i zbatimit të kontratës së konsulentit M.....rezulton se janë kryer 7 amendime të kontratës, respektivisht katër për Fazën 1 dhe tre për Fazën 2.

Amendimet e kontratës gjatë Fazës së I:

- Me shkresën datë 12.03.2010 konsulenti M..... ka informuar se për shkak të një ristrukturimi projekti do t'i përcillet një kompanie tjetër, e cila do të përmbushi detyrimet e kontratës së lidhur. Të gjendur para këtij fakti është kryer Amendimi nr. 1, datë 08.09.2010 ku konstatohet se është ndryshuar konsulenti nga "M...." në "G....". Ky ndryshim është kryer pa analizuar nëse konsulenti i ri "G....." plotëson apo jo kushtet që plotësonte "M....." që u vlerësua mbi kushtet që ishin vendosur në dokumentet e tenderit. Gjithashtu ky ndryshim denatyrton edhe vetë procedurën e tenderit e cila u zhvillua për të përzgjedhur konsulentin që plotëson kushtet e vendosura me një ofertë ekonomike.Ky ndryshim është në kundërshtim me nenin 1.3 të Kontratës së Konsulencës "Konsulenti nuk ka të drejtë të caktojë apo transferojë asnjë të drejtë apo detyrim pjesore apo të plotë të kontratës pa marrë një miratim nga punëdhënësi".

Për këtë rekomandojmë:

OST Sh.A dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen në kontratat e konsulencës për projekte me financime të huaja të ruajnë marrëdhëniet kontraktuale me operatorët ekonomik të shpallur fitues nga procedura e tenderimit dhe jo duke i ndryshuar ata me amendime kontratash.

Vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Për realizimin e shërbimit të konsulencës është lidhur kontrata me datë 24.09.2009, e llojit "lumps sum" (kryerje pagesash pjesore në % sipas realizimit të shërbimit mbështetur në grafikun e miratuar) me "M....", e me pas me Amendimin nr. 1 shërbimi i konsulencës është kryer nga një tjetër kompani (I....).Nga auditimi i kryerjes së pagesave rezulton se bashkëlidhur aplikimit për kryerjen e pagesave është fatura e konsulentit dhe verifikimi i kryer nga shef i PIU-t.Këto fatura janë dorëzuar për pagesa pas dorëzimit të raportit të progresit, bashkëlidhur faturës mungojnë dokumentat justifikuese të shpenzimeve të kryera, edhe pse kontrata është e llojit lump sum, ajo ka një plan shpenzimesh që do të kryhen nga konsulenti gjatë ofrimit të shërbimit. Këto pagesa janë kryera në kundërshtim me aneksin 6 të Ligjit nr. 10248, datë 11.3.2010 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Sh.A., "Linja e transmetimit 400 KV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë)".

Për këtë rekomandojmë :

OST Sh.A dhe PIU të marrin masa që konsulenti të dorëzojë të gjitha dokumentet justifikuese për shpenzimet e kryera dhe të faturuara në kuadër të zbatimit të kontratës dhe procedurave të parashikuara në marrëveshjen e huasë.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në objekt për zbatimin e kontratës “Linja e transmetimit 400 KV Shqipëri-Kosovë, Loti i II-të ” u konstatua se:

- Zbatuesi i kontratës për lotin e dytë nuk ka bërë përkthimin në gjuhën shqipe të manualeve të operimit dhe të mirëmbajtjes, në zbatim të kushteve të veçanta të kontratës (KVK) , seksioni VIII, pika 1.4 (Ligji dhe gjuha) germa (b) Dokumentimi.
- Për trajnimin e kryer me datë 29.01.2016 në nënstacionin Tirana 2 mbi Shunt reaktorin, personat e trajnuar nuk janë pajisur me certifikatë trajnimi, veprim ky në kundërshtim me kontratën për punë publike.

Për këtë rekomandojmë :

OST Sh.A, të marrë masa që t’i kërkojë zbatuesit të kontratës “ABB”AG G të realizojë përkthimin e manualeve të përdorimit në zbatim të specifikimeve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, si dhe nisur nga fakti se personat e trajnuar kanë dokumente që provojnë kryerjen e trajnimit, të realizojnë pajisjen e të trajnuarve me certifikatë trajnimi.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi:

Nisur nga shtyrja e afatit të disbursimeve me 1,5 vjet dhe shuma e konsiderueshme e fondeve të kursyera nga huaja prej rreth 7 milion euro me ligjin nr. 64/2016, datë 19.06.2016 për “Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe projektit” OST Sh.A pa të arsyeshme që fondet e mbetura të përdoren për zgjerimin e nënstacionit Koman me një transformim 400/220 KV në kuadër të projektit “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 KV Kosovë-Shqipëri”. Linja për zgjerimin e nënstacionit Koman me një transformim 400/220KV është tenderuar dhe është nënshkruar kontrata me kontraktorin por ende nuk kanë filluar punimet. Afati i shtyrjes së disbursimeve është deri në datë 31.12.2017 duke bërë të vështirë që zgjerimi i kësaj linje të bëhet brenda afatit të përcaktuar nga KfW pasi afati i mbetur nga shtyrja është 5 muaj dhe punimet për këtë nënstacion nuk kanë filluar ende.

Për këtë rekomandojmë :

Nga OST Sh.A, të merren masa që të nisin sa më parë punimet për linjën e zgjerimit të nënstacionit Koman që të arrihet të kryhet brenda afatit në datë 31.12.2017 të parashikuar me ligjin nr. 64/2016, datë 19.6.2016 për “Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe projektit”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik me vlerë 283,298 Euro. Në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Linja e transmetimit 400 KV Shqipëri-Kosovë” u konstatuan se është financuar operatori ekonomik “E.....” me drejtues ligjor z. E. Ç, për punime të pakryera në objekt dhe mos argumentim të kryerjes se shërbimeve të përgjithshme me dokumentacion justifikues duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në shumën 241,239 Euro duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Për këtë rekomandojmë :

OST Sh.A të marrë masa, që t'i kërkojë operatorit ekonomik "E...." duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 241,239 Euro, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Për realizimin e shërbimit të konsulencës është lidhur kontrata me datë 24.09.2009, e llojit "lump sum" me "M....." Pagesa e parë për shërbimin e konsulencës është kryer në datë 22.10.2009 në bazë të kushteve të kontratës për parapagimin në vlerën 42,059 Euro për kompaninë "M.....". Ndërkohë që me Amendimin nr. 1 datë 08.09.2010 konstatohet se është ndryshuar konsulenti nga "M....." në "G...." Vlera prej 42,059 Euro është përfituar padrejtësisht nga konsulenti "M....." pasi ai e ka ndërprerë shërbimin e konsulencës në datë 08.09.2010 dhe është vazhduar me shërbim nga kompania "G....".

Për këtë rekomandojmë :

OST Sh.A dhe PIU të marrin masa për arkëtimin e parapagimit të kryer ndaj "M....." në shumën 42,059 Euro, si pagesë të përfituar padrejtësisht, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe kontabilizuar detyrimin.

Menjëherë

C.SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditim rezulton se për projektin "Linja e transmetimit 400 KV Shqipëri – Kosovë (Tiranë -Prishtinë)" OST Sh.A i ka paguar Ministrisë së Financave tarifën e dibursimit për periudhën vitet 2010-2016 shumën 590,538 Euro. Kjo shumë përbënë një shpenzim jo efektiv të kryer nga OST Sh.A në shumën 590,538 Euro për shkak të tejzgjatjes të procedurave të tenderit dhe ritenderimit. Për çdo pagesë Ministria e Financave i ka dërguar OST Sh.A detyrimin përkatës për këto shuma dhe më pas është kryer pagesa nga OST Sh.A.Në përgjithësi pagesat janë kryer brenda afateve të parashikuara në marrëveshje vetëm me devijime të vogla në disa raste.

Për këtë rekomandojmë :

- OST Sh.A dhe PIU të marrin masa që të mos ketë shtyrje të mëtejshme të procesit të zbatimit të projektit duke eliminuar thellimin e mëtejshëm të efektit negativ prej 590,538 Euro si pasojë e pagesës së tarifës së disbursimit.

- OST Sh.A dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me përpikëri afatet në çdo fazë të implementimit të tij (nga tenderimit e deri te zbatimit i punimeve) me qëllim arritjen në kohë të objektivave të tij dhe minimizimin e efekteve financiare nga pagesa e tarifave të disbursimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

2. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i procedurës së tenderit Loti 1 "Ndërtimi i linjës 400 KV Shqipëri-Kosovë" ,rezulton se vendimi për anulimin e procedurës së tenderit është marrë nga OST bazuar në faktin se oferta e renditur e dyta është teknikisht e përgjegjshme dhe me një diferencë të madhe nga operatori i renditur i pari. Por kriteri i tenderit e bënte të pamundur vazhdimin e negociatave me të. Konstatohet gjithashtu se vetëm procesi i anulimit të tenderit ka zgjatur 1 vit dhe gjithë periudha e nga tenderi i I-rë e deri në ritenderim është 2.5 vite. Ky ka sjell vonesa të paarsyeshme dhe ka sjell edhe një anomali të projektit pasi OST Sh.A është gjetur

para faktit që duhet të bënte edhe ndryshime të marrëveshjes pasi do të fillonte periudha e shlyerjes së kredisë akoma pa filluar disbursimi. Vetëm për këtë periudhë tarifa e angazhimit të huasë së projektit e përcaktuar në marrëveshje është 287,583 euro vlerë e cila ka rritur koston e projektit dhe një shpenzim jo efektiv. Gjithashtu për hartimin dhe zhvillimin e procedurës së ritenderimit OST Sh.A ka kryer Amendimin nr. 2 të kontratës së konsulentit me vlerë 140,000 euro vlerë e cila është paguar nga vetë OST Sh.A pasi nuk mbulohet nga asnjë nga fazat, ky shpenzim i kryer nga OST Sh.A është joefektiv pasi vjen si pasojë e një anulimi të gabuar të procedurës së tenderit.

Për këtë rekomandojmë :

OST Sh.A dhe PIU të marrin masa që në të ardhmen në procedurat e tenderimit me financime të huaja të përcaktojnë si kriter kualifikues të fazës përfundimtare çmimin më të ulët me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomicitet, efektivitet, dhe efencë.

Menjëhe re dhe në vazhdimësi.

D. TË TJERA

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e rradhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

4.UK SHA, POGRADEC PËR PROJEKTIN “KANALIZIMET E POGRADECIT FAZA II”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit UK SHA, Pogradec për projektin për projektin “Kanalizimet e Pogradecit faza II”, nr.233/1 prot, datë 11.10.2017, rezultoi se UK SHA, Pogradec ka hartuar programin dhe ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga data e njoftimit të raportit të përfundimtar të auditimit.

UK SHA, Pogradec për projektin për projektin “Kanalizimet e Pogradecit faza II”, i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

- Janë rekomanduar 8 masa organizative, nga të cilat është zbatuar pjesërisht 1 masë, janë në proces zbatimi 6 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë.
- Janë rekomanduar 3 masa për shpërbllim dëmi, nga të cilat 3 masa janë në proces zbatimi.
- Është rekomanduar 1 masë administrative nga e cila 1 masë është zbatuar pjesërisht.

Për sa më sipër rikërkojmë që UK SHA, Pogradec për projektin për projektin “Kanalizimet e Pogradecit faza II”, të marrin masa të zbatojë të gjitha rekomandimet që rezultuan të pa zbatuara në përputhje me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 20 ditëve, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Projekti “**Mbrojta Mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet, Pogradec III**” financohet nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW në formën e huasë dhe kontributit financiar, me një kosto totale të parashikuar në vlerën **13,456 milionë Euro**, ndër të cilat shuma e huasë është **10 milion Euro** ndërsa pjesa tjetër e mbetur **3,456 milion Euro** financohet nga fondet IPF/MË. Kontributi financiar rregullohet me ligjin Nr. 10411 datë 07.04.2011 për ratifikimin e "Marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga

Ministria e Financave dhe Ujësjetllës Kanalizime SHA, Pogradec, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW për financimin e programit "Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet, Pogradec III". Huaja rregullohet nga ligji nr. 10412 date 7.4.2011, për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ujësjetllës-kanalizime, Pogradec, si Agjenci e Zbatimit të Projektit, dhe KfW për financimin e programit "Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet, Pogradec III". Më datë 25.05.2011 është nënshkruar marrëveshja e nën-huasë midis Ministrisë se Financave dhe Ujësjetllës Kanalizime Pogradec ku Ministria e Financave i jep UK Pogradec një nën-hua që nuk e kalon vlerën 10 milion Euro me afat deri më **31.12.2015**. Ky afat është shtyrë për **30 Dhjetor 2018** sipas dokumentit të nënshkruar më 14.06.2016 për ndryshimin e marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës se Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Ujësjetllës Kanalizimeve Pogradec, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main. Në marrëveshjen e nënhuasë borxhi do të shlyhet në një periudhë 30 vjeçare duke filluar nga data 30 Qershor 2021. Sa më sipër njësia e zbatimit të projektit, nuk ka bërë një analizë ku të përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe te jepen argumentet për vonesën e realizimit të projektit.

Rekomandimi: UK sha, të marrë masa për hartimin e një raporti ku te përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe te jepen argumentet për vonesën e realizimit të projektit duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse dhe të përcaktojë masat e nevojshme për përfundimin e gjithë aktiviteteve të projektit.

Brenda datës 30.07.2018

2. Gjetje: Agjencia e Ekzekutimit të Projektit nuk ka përgatitur asnjë projekt raport si dhe as nuk ka firmosur raportet katër mujore të përgatitura nga konsulenti mbi progresin e Projektit, siç specifikohet në marrëveshjen e veçantë, datë 23.12.2010, të marrëveshjes së Huasë dhe Projektit si dhe marrëveshjes së Financimit dhe Projektit, pika IV.1 "Raportimi". Në marrëveshjen e veçantë, datë 23.12.2010, të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit si dhe Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit, pika IV.1 "Raportimi", në të cilën shkruhet se: "Agjencia e Ekzekutimit të Projektit, duhet të raportojë tek KfW dy herë në vit për progresin e Projektit. Progres raporti duhet të përfshijë të gjitha pikat e renditura në Aneksin 9, të marrëveshjes së veçantë. Në rastet kur Agjencia e Ekzekutimit të projektit ka ngarkuar konsulentin për përgatitjen e progres raporteve dhe raportit përfundimtar, ajo ka për detyrë të komentojë ose aprovojë me firmë dokumentin". Edhe pse në pretendimet e UK sha. Pogradec thuhet se këto raporte janë përgatitur, grupit të auditimit të KLSH nuk ju dhanë në formë të dokumentuar.

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime sha Pogradec, të marrë masa që në të ardhmen për projekte me financime të huaja të bëjë raportimin tek donatorët në përputhje me detyrimet e Marrëveshjes së Huasë.

Brenda datës 30.07.2018

3. Gjetje: Në Agjencinë e Zbatimit të Projektit, nuk është bërë dorëzimi i dokumentacionit dhe marrja e detyrës me procesverbal nga punonjësit pasardhës, veprime që kanë sjellë vështirësi në auditim për vënien në dispozicion të dokumentacionit, rakordimin e shumave dhe veprimeve të kryera për projektin nga fillimi i tij deri në periudhën e auditimit. Dokumentacioni i projektit prej fillimit për të gjitha fushat e projektit (financimi, prokurimi, dhe dokumente të tjera si e-maile me konsulentin dhe kontraktorin, korespondenca zyrtare midis tyre si dhe ajo me KfW), nuk është inventarizuar dhe arkivuar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", nenin 4/26, si dhe me "Norma tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 7, udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", dalë në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Pogradec, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit, si dhe të dokumentacionit tjetër të projektit, nga fillimi i projektit e në vazhdim.

Brenda datës 30.07.2018

4. Gjetje: Në tenderin e zhvilluar me objekt: **“Kanalizimi i ujrave të zeza, faza III”, punime” Loti I**, me fondi limit pa tvsh 10,594,362 Euro, me operator ekonomik fitues “A....” shpk, Shqipëri, me vlerë të kontratës pa tvsh 6,897,485.84 Euro, me diferencë nga fondi limit 3,696,876.16 Euro, rezultoi se **nuk ka oponencë teknike, as për pjesën e parë të kontratës si dhe për dy shtesat e bëra, përkatësisht në vlerat 6,897,485 Euro dhe 3,469,621 Euro**, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 2.

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime sha, Pogradec, të marrë masa që në të ardhmen për projektet me vlerë mbi 1,000.000 lekë të kryera me fonde publike apo me financime të huaja, të bëjë oponencën teknike në përputhje me aktet ligjore të Republikës së Shqipërisë.

Vazhdimisht

5. Gjetje: Nga auditimi i likuidimeve të punimeve u konstatua se është paguar për pajisje dhe makineri tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH). Kjo pagesë është kryer në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 180, datë 13.2.2013 “Për Përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzim nr.1, datë 16.6.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të cilët specifikojnë përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të pajisjeve dhe makinerive, duke krijuar një dëm ekonomik të arkëtueshëm nga subjekti “A.....” shpk, Shqipëri në shumën 147,22,620.7 lekë.

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime sha Pogradec, të marrë masa që në likuidimin e punimeve të ndërtimit me fondet e veta apo hua, të marrë në konsideratë listën e makinerive e pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin si dhe procedurat e përjashtimeve me kriteret përkatëse në përputhje me aktet ligjore të Republikës së Shqipërisë.

Vazhdimisht

6. Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Kanalizimi i ujrave të zeza, faza III”, punime, Loti I”, të lidhur me kontraktorin “A.....” shpk, datë 17.04.2013, në vlerë 6,311,486.13 Euro, dhe shtesës së kontratës në vlerën 3,696,876.16 Euro, me afat kohor 690 ditë kalendarike, rezultoi se nga ana e këtij kontraktorit është paraqitur certifikatë sigurimi për ofrimin e sigurimit kundër dëmtimit të personave dhe pronës, palës së tretë. Ky sigurim mban datën 12.05.2013, dhe mbulon periudhën 29.04.2013 – 29.03.2015. Për periudhën mbas datës 29.03.2015 e deri më datë 14.07.2017, nuk ka asnjë certifikatë sigurimi për mbulimin e sigurimit, në kundërshtim “Kushtet e Kontratës për ndërtim, e punimeve ndërtimore dhe inxhinierike të projektuara nga punëdhënësi”, pika 14, “Cmimi i kontratës dhe pagesa”, pika 14.3, “Kërkesa për Çertifikatat e Pagesave të Ndërmjetme”, si dhe pika 14.7/b, “Pagesa” të FIDIC.

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime sha Pogradec, të marrë masa që në të ardhmen të kërkojë zbatimin e kushteve të kontratës në lidhje me sigurimet në përgjithësi dhe sigurimi për ofrimin e sigurimit kundër dëmtimit të personave dhe pronës, palës së tretë ne veçanti.

Vazhdimisht

7. Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit të tenderit të zhvilluar me objekt: “Furnizimi i kimikateve për eliminimin e fosforit, Fe CL SO₄, sasia 290 m³”, loti III, me fond

limit pa tvsh 500,000 Euro, me subjekt fitues “Ch.....” spa, Itali, me vlerë të kontratës pa tvsh 144,216.8 Euro, me diferencë nga fondi limit 355,783.2 Euro, rezultoi se fondi limit i përlogaritur nga konsulenti ka qenë tejte i fryrë (ofertat e paraqitura janë rreth 3.3 herë më pak se fondi limit), fakt i cili vërtetohet me konsumin e kimikatit i cili deri më datë 30.04.2018, parashikohet të jetë në masën 44.48%. Konsulenti ka sugjeruar që shumën e mbetur prej 67,350 Euro mund të përdoret për të investuar në një konvertues të tretë dhe të katërt në Tushemisht PS. Për rrjedhojë përlogaritja e nevojave për këtë procedurë prokurimi nuk është bërë e saktë për të cilën ngarkohet me përgjegjësi konsulenti.

Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime sha Pogradec, të marrë masa që në të ardhmen në përlogaritjen e nevojave për materiale (kimikate) etj., të përcaktojë sasitë në përputhje me nevojat e kësaj shoqërie.

Vazhdimisht

8. Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt: “Furnizimi i kimikateve për eliminimin e fosforit, Fe CL SO₄, sasia 290 m³”, loti III, me fond limit pa tvsh 500,000 Euro, me subjekt fitues “Ch....” spa, Itali, me vlerë të kontratës pa tvsh 144,216.8 Euro, rezultoi se bazuar në korespondencën midis KfW dhe UK sha Pogradec, afati i përfundimit të kontratës është data 30.04.2018, ndërkohë që konsulenti ka paraqitur një grafik ku lëvrim i mallit bëhet në 20 pjesë, deri më datë 09.09.2020, datë që tejkalon afatin e disbursimit të kredisë, e cila është deri më 30.12.2018. Nga ana e konsulentit me datë 30.05.2017, është vendosur që: “sipas parashikimit nisur nga lëvrimi i fundit dhe të disbursimit, deri në datë 30.04.2018, nuk do të dorëzohet një sasi prej rreth 129 m³ precipitues”, e cila korrespondon me një vlerë financiare prej rreth 67,350 Euro, duke anuluar zërat nr. 10 -20 të furnizimit.

Për rrjedhojë rezulton se mbas datës 30.04.2018, kontrata do të ndërpritet dhe **mund të shoqërohet me sanksione nga kontraktori, me efekt financiar për buxhetin e UK sha**, bazuar në “Short form of contract”, “Green book”, pikat 12.2 dhe 12.4.

Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime sha Pogradec, deri në datën e mbylljes së financimeve nga ana e KfW, duhet të marrë masat e duhura për zgjidhjen e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga ana e saj, me konsulentin dhe KfW, për sanksionet e mundshme.

Menjëherë

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. **Gjetje:** Nga auditimi i likuidimit të kontratës së lidhur për punë civile me kontraktorin “A.....” shpk, me objekt “**Kanalizimi i ujrave të zeza, faza III**”, **punime** Loti I, me fond limit pa tvsh 10,594,362 Euro, me operator ekonomik fitues “Albstar shpk, Shqipëri, me vlerë të kontratës pa tvsh 6,897,485.84 Euro, të lidhur më datë 17.04.2013, në vlerë 6,311,486.13 Euro, dhe shtesës së kontratës në shumën limit 3,696,876.16 Euro, rezultoi se në likuidimin e situacioneve nuk ka të dhëna dokumentare në lidhje me kapitullin “Kërkesa të përgjithshme” (General requirements)” për të cilat janë likuiduar:

- për kontratën bazë në shumën 423,749.15 Euro + tvsh 20% = **508,498.98 Euro**,

- për kontratën shtesë shumën prej 186,780 Euro dhe me tvsh **224,136 Euro**

Likuidimi i shumës prej **732,634.98 Euro**, pa u argumentuar me dokumentacion përkatës është në kundërshtim me bazën ligjore të FIDIC, me “Kushtet e Kontratës për ndërtim, e punimeve ndërtimore dhe inxhinierike të projektuara nga punëdhënësi”, pika 14, “Çmimi i kontratës dhe pagesa”, pika 14.3, “Kërkesa për Çertifikatat e Pagesave të Ndërmjetme”, si dhe pika 14.7/b, “Pagesa”, **shumën të cilat përbëjnë dëm ekonomik, të arkëtueshëm nga subjekti “A.....” shpk.**

Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime sh.a, Pogradec, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “A.....” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **732,634.98 Euro**, të cilën e ka përfituar tepër për zëra të preventivit të pa argumentuara me dokumentacion.

Menjëherë

2. Gjetje: Nga auditimi i likuidimit të kontratës së lidhur për punë civile, me objekt “**Kanalizimi i ujrave të zeza, faza III**”, punime” **Loti I**, me kontraktorin “A.....” shpk, të lidhur më datë 17.04.2013, në vlerë 6,311,486.13 Euro, rezultoi se është paguar për pajisje dhe makineri, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH). Kjo pagesë është kryer në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 13.2.2013, “Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”, Udhëzimin e Këshillit të Ministriave nr 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzim nr.1, datë 16.6.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të cilët specifikojnë përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të pajisjeve dhe makinerive, në shumën **14,722,620.7 lekë**.

Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime sh.a, Pogradec, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “A.....” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **14,722,620.7 lekë**, të cilën e ka përfituar tepër për TVSH për makineri e paisje.

Menjëherë

3. Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile, të kontratës së lidhur me kontraktorin “A.....” shpk, datë 17.04.2013, në vlerën 6,311,486.13 Euro, rezultuan punime të pakryera apo diferenca për punime të pakryera në shumën **14,618.28 Euro, dëm ekonomik** i arkëtueshëm nga subjekti “A.....” shpk, Shqipëri.

Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime sh.a, Pogradec, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “A.....” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **15,820.86 Euro**, shumë e cila përfaqëson punime të pakryera apo diferenca për punime të pakryera.

Menjëherë

C.MASA ADMINISTRATIVE

1. Masa: Ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime sha, Pogradec, të marrë masa për të shpallur si të pa pranueshëm për lidhjen e kontratave për konsulencë kompaninë JV “D.....” Gjermani, për mos dokumentimin e sigurimit kundër dëmtimit të personave dhe pronës, palës së tretë, për përloqaritjen e gabuar të nevojave për kimikate, për mos dokumentimin e pagesave të zërit të preventivit për “Kërkesat e përgjithshme”, për pagesa me tvsh për makineri e paisje, si dhe për punime civile të pakryera apo diferenca për to, me pasojë dëm ekonomik të shkaktuar në shumën **747,252.99 Euro dhe 14,722,620.7 lekë**. Gjithashtu kjo ndërmarrje të marrë masa për njoftimin e Bankës KfW, si dhe Agjencinë e Prokurimit Publik.

Menjëherë

D. TË TJERA

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e rradhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

5.KRWM SHA, KORÇË PËR PROJEKTIN “MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA TË SHQIPËRISË JUGLINDORE”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit KRWM sh.a Korçë për projektin për projektin “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta tw Shqipërisë Juglindore”, nr. 375/9 prot, datë 01.08.2017, rezultoi se KRWM sh.a Korçë nuk ka hartuar programin dhe ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga data e njoftimit të raportit të përfundimtar të auditimit.

KRWM sh.a Korçë për projektin për projektin “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta tw Shqipërisë Juglindore”,i ka trajtuar rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 20 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk janë zbatuar 10 masa.

- Janë rekomanduar 5 masa për shpërbllim dëmi nga të cilat, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa.

-Është rekomanduar 1 masë për shpenzime të kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E) nga e cila është zbatuar plotësisht 1 masë.

-Janë rekomanduar 2 masa disiplinore, nga të cilat 2 masa janë zbatuar pjesërisht.

- Është rekomanduar 1 masë administrative, nga e cila 1 masë nuk është zbatuar.

Për sa më sipër *rikërkojmë* që KRWM sh.a Korçë për projektin për projektin “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta të Shqipërisë Juglindore”,të marri masa të zbatojë të gjitha rekomandimet që rezultuan të pa zbatuara në përputhje me nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 20 ditëve, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: KRWM sh.a, sipas ligjeve nr. 10400, datë 24.03.2011 dhe nr. 102/2013, datë 25.03.2013, është Agjensia Zbatuese e Projektit "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore" nëpërmjet të cilit përfitohet një hua prej 3,4 milion Euro dhe një grant prej 8,4 milion Euro, gjithsej 11,8 milion Euro nga Banka Gjermane për Zhvillim (KFW). Ky fond lëvrohet përmes KRWM sh.a. në kuadër të “Marrëveshjes së huasë, financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Shoqatës Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Korçë (KRWM) dhe KFË Frankfurt am Main për financimin e projektit “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë”, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Agjencia e zbatimit të projektit KRWM sh.a, është themeluar më datë 05.06.2008, formuar nga 28 pushtete vendore të Qarkut Korçë, bazuar në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore dhe mbas ndarjes së re territoriale me 6 bashki. KRWM sh.a është regjistruar në përputhje me ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në kushtet aktuale kur KRWM sh.a, punon me 6 bashki, organizimi dhe funksionimi i kësaj shoqërie rezultoi se nuk ka një rregullore të brendshme me qëllim mbarëvajtjen dhe organizimin e punës në lidhje me menaxhimin e projektit.

Rekomandimi: KRWM sha të hartojë dhe miratojë në organin kompetent përkatës rregulloren e brendshme të funksionimit të shoqërisë me përshtime dhe detyra të mirë përcaktuara me qëllim

organizimin dhe funksionimin me efektivitet të shoqërisë, në përputhje me misionin që i është përcaktuar në marrëveshjen e projektit.

Menjëherë

3. Gjetje: Organi kontrollues i funksionimit dhe aktiviteteve të Shoqërisë është Këshilli Mbikqyrës, i përbërë nga 5 anëtarë të zgjedhur nga asambleja e aksionerëve.

Nga auditimi rezultoi numri i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës së shoqërisë gjate viteve objekt auditimi ka qenë gjashtë, ka ndryshuar në shtatë dhe aktualisht në bazë të vendimit të asamblesë së përgjithshme është pesë anëtarë, duke u kategorizuar si këshill për shoqëritë e sektorëve strategjikë me rëndësi të vecantë, veprim ky në kundërshtim me VKM nr.642, datë 11.10.2005, pika 1a. Nga shqyrtimi i dosjeve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës pranë zyrave të KRWM sh.a rezultoi se në to ndodhet vetëm CV e anëtarëve të këshillit, pa dokumentet vërtetuese të saj. Gjithashtu nga KRWM sha, nuk është sqaruar fakti nëse këta anëtarë këshilli janë anëtarë të ndonjë këshilli tjetër mbikqyrës me qëllim llogaritjen e sakte të shpërblimit të tyre.

3.1.Rekomandim: Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe KRWM sha, të marrë masat e duhura për zvogëlimin e numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, duke emëruar dhe funksionuar vetëm me tre anëtarë, në zbatim të akteve nënligjore mbi funksionimin e këshillave mbikqyrës të shoqërive anonime me kapital shtetëror, duke u kategorizuar si shoqëri jo strategjike.

Brenda dates 30.07.2018

3.2.Rekomandim: Asambleja e Përgjithshme e KRWM sh.a, të marrë masat e duhura për shqyrtimin e dosjeve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë, vërtetimin e të gjitha CV të anëtarëve të këshillit duke ju përmbajtur me rigozitet kritereve të përcaktuara për përzgjedhjen e tyre, si dhe verifikimin nëse janë anëtarë në këshilla të tjerë.

Brenda dates 30.07.2018

4. Gjetje: Pas reformës administrative – territoriale, me krijimin e bashkive të mëdha dhe përfshirjen në to të ish-komunave ka filluar zbatimi ose rritja e tarifave të pastrimit për zonat rurale. Më 29 mars 2016, në takimin e përbashkët të gjashtë bashkive 4 aksionere të KRWM sh.a, është rënë dakord mbi mënyrën e pagesës për shërbimet e ardhshme të venddepozitimit dhe transferimit të mbetjeve, si dhe është pranuar në parim rritja e ndjeshme e tarifës së pastrimit, për të mbuluar kostot e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve. Nga auditimi rezulton se pavarësisht të gjitha përpjekjeve, fakt mbetet niveli i ulët i arkëtimit të kontributeve të aksionerëve duke riskuar qëllimin kryesor të funksionimit të KËRM sha, si dhe financimin e saj, sepse aksionerët e KRWM sh.a janë aktorët kryesorë të cilët me vullnetin e tyre mbështesin aktivitetet dhe ecurinë e KRWM sha, si parakusht i panegociueshëm për lëvrimin e fondeve nga Banka Gjermane për Zhvillim.

Rekomandim: KRWM sh.a/ njësia e zbatimit të projektit të marrë masat e nevojshme ligjore në mënyrë që në vazhdimësi detyrimet e aksionerëve ndaj shoqërisë të jenë të rregullta, me qëllim mbarëvajtjen e shoqërisë në cilësinë e njësisë së zbatimit të projektit, në mënyrë që të përmbushen detyrimet në interes të bashkësive që përfaqsojnë.

Brenda datës 30.07.2018

5. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se projekti nuk ka arritur të përfundojë në afat, duke mos u realizuar objektivat e kërkuar për të shfrytëzuar në kohë sa më të shpejt investimin, të cilët ishin të parashikuara të arriheshin me përfundimin e zbatimit të projektit në nëntor të vitit 2015, por deri në fund të periudhës objekt auditimi (janar 2013 - maj 2017) konstatohet se përsa i përket disbursimeve janë realizuar vetëm në masën 71.39% të vlerës së kontratës së punimeve ndërsa

realizimi kohor për ndërtimin e landfillit është tejkaluar në masën 51%, në kundërshtim me aneksin 3, të ligjit nr. 102/2013, datë 25.03.2013, ndërsa kontrata e konsulentit është realizuar në masë 91%. Projekti nuk ka mundur ende të përmbush objektivin kryesor.

Për sa i përket mosrealizimit të projektit brenda afatit të përcaktuar në Marrëveshjet financiare, përgjegjësia është e strukturave të përfshira në realizimin e projektit, të cilat nuk kanë marrë masat e duhura për përfundimin e projektit në afat dhe si pasojë për realizimin e tij është kërkuar shtyrja e afatit të përfundimit deri në vitin 2018, shtyrje e cila është kërkuar 14 muaj me vonesë.

KRWM sha/ njësia e zbatimit të projektit, nuk ka bërë një analizë ku të përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe te jepen argumentet për vonesën e realizimit të projektit.

Rekomandimi: KRWM sha/ njësia e zbatimit të projektit, të marri masa për hartimin e një raporti ku te përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe te jepen argumentet per vonesën e realizimit te projektit duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse dhe të përcaktojë masat e nevojshme për përfundimin e gjithë aktiviteteve të projektit.

Brenda datës 30.07.2018

6. Gjetje: Në bazë të marrëveshjes se financimit me qëllim për të garantuar operimin e duhur të projektit, agjencia e zbatimit të projektit përshtat strukturën organizative siç është përgatitur gjatë zbatimit të projektit nga konsulentët e masave shoqëruese dhe rekruton personel sipas parashikimit në të, para dhënies së punëve të ndërtimit për vendgrumbullimin sanitar në Maliq. Për periudhën objekt auditimi rezulton se struktura e organizative pranë Njesisë së Zbatimit të Projektit e cila përbëhet nga një staf prej 4 punonjësish, nuk është miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës dhe nuk ka detyra të përcaktuara për funksionimin dhe organizimin e stafit të njesisë së menaxhimit të projektit. Administratore e përgjithshme e shoqërisë KRWM sh.a, me profesion ekonomiste-financiere është emëruar në këtë detyrë me vendimin nr. 08, datë 15.11.2008 të Këshillit Mbikqyrës. Pjesa tjetër përbëhet nga një staf me profesion inxhinier minierash, me profesion financiere dhe me profesion shofer/fadrome. Vihet re që në përbërje të këtij stafi mungon një jurist i cili do të duhet të kryente një konsulencë juridike shtesë në ndihmë të funksionimit të administratorit të përgjithshëm për marrëdhëniet juridike me të tretët si dhe për vetë rëndësinë që ka funksionimi sa më i saktë i njesisë së zbatimit të projektit në tërësi. Marrëdhëniet e punës së stafit organizativ të KRWM sh.a janë të rregulluara me kontrata individuale pune, referenca ligjore e këtyre kontratave rezultoi se nuk ishte e saktë, pasi nuk ka asnjë vendim të Këshillit Mbikqyrës, në të cilin mbështeten, nuk janë të cituara nenet e statutit si dhe këto kontrata i referohen rregullore së brendshme të shoqërisë, kur një rregullore e tillë nuk ekziston.

6.1.Rekomandim: KRWM sh.a të marrë masa për plotësimin e strukturës organizative të shoqërisë me jurist dhe me staf tjetër mbështetës, sa më të kualifikuar duke u bazuar edhe në sugjerimet e konsulentit për masat mbështetëse, me qëllim mirë funksionimin e njesisë së zbatimit të projektit si dhe dhënien e sigurisë për menaxhimin sa më të saktë të projektit në vazhdimësi.

Brenda dates 30.07.2018

6.2.Rekomandim: KRWM sha. të miratojë strukturën e stafit organizativ të shoqërisë si dhe të rregullojë marrëdhëniet e punës së punonjësve me kontrata individuale, kontrata të cilat të jenë të bazuara ligjërisht.

Brenda dates 30.07.2018

7. Gjetje: Gjatë gjithë periudhës së mandatimit të tij, Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë ka funksionuar në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe eneteve publike”, ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për

tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, VKM nr.642, datë 11.10.2005, “Mbi funksionim e këshillave mbikqyrës të shoqërive aksionere” si dhe me statutin e shoqërisë, për arsye se nuk ka nxjerrë asnjë vendim i cili të sigurojë se veprimtaria dhe funksionimi i shoqërisë është në përputhje me ligjet dhe statutin. Nuk ka zgjedhur sekretarin e këshillit, i cili si detyre kryesore ka mbajtur dhe dokumentimin e procesverbaleve të mbledhjeve dhe vendimeve të këshillit,. Si pasojë këshilli mbikqyrës pothuajse në të gjitha rastet nuk ka regjistruar zhvillimin dhe pjesmarrjen në mbledhje, nuk ka të dokumentuara çështjet e diskutuara dhe marrjen e vendimeve sipas votimit. Libri i protokollit të mbledhjeve të këshillit drejtues nuk ka të regjistruar asnjë vendim që nga periudha e krijimit të shoqërisë. Nga stafi i KRWM sh.a janë mbajtur disa procesverbale mbledhjesh me shkrim dore në blloqe të ndryshme të cilat nuk janë firmosur në asnjë rast nga anëtarët e këshillit.

Rekomandim: KRWM sh.a, të marrë masa për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, duke i zëvendësuar me anëtarë të tjerë, në përputhje me kriteret e miratuara nga Asambleja e Aksionerëve dhe me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse, në fuqi.

Brenda datës 30.07.2018

8. Gjetje: Nga auditimi rezulton se në zbatimin e këtij projekti u konstatuan vonesa për një periudhë më shumë se 2,5 vjet si rezultat i vonesave në shpronësime, leje zhvillimore, nga proceset e tenderimit, etj, duke sjellë për pasojë që grafiku kohor i punimeve të projektit, i miratuar me marrëveshjen e financimit të ndryshojë edhe pse nuk ka ndonjë amendim nga palët, të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen e projektit dhe të financimit. Agjensia e zbatimit të projektit nuk ka kërkuar amendim të marrëveshjes.

Rekomandim: KRWM sha, për projektet në vazhdim të marrë masat që t'i përmbahet rigorozisht grafikut kohor të punimeve të projektit të miratuar me marrëveshjen e financimit dhe në raste të pashmangshme të vonesave të kërkojë amendimin e marrëveshjes, duke përditësuar grafikun kohor të punimeve.

Vazhdimisht

10. Gjetje: Nga auditimi rezultoi se nga KRWM sh.a, si agjenci ekzekutuese, nuk janë hartuar dhe dorëzuar te Banka raporte mbi ecurinë e projektit, Banka ka marrë raportime vetëm nga Konsulenti. Agjencia e zbatimit të projektit nuk ka komentuar mbi raportet e paraqitura nga konsulenti te banka, duke mos bërë të ditur aprovimin e përmbajtjes së tyre, duke i sigluar ose komentuar, veprime në kundërshtim me marrëveshjet e veçanta të zbatimit të parashikuara në seksionin II.4 të marrëveshjes financiare si dhe të gjitha kushteve të tjera të përgjithshme.

Rekomandim: KRWM sha, të marrë masa që deri në përfundimin e plotë të projektit të përgatisë dhe të dorëzojë te Banka KFW informacion mbi ecurinë e projektit sipas marrëveshjeve financiare të miratuara.

Vazhdimisht

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni i procedurave të prokurimit nuk është i inventarizuar dhe i arkivuar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, nenin 4/26.

Rekomandim: KRWM, sha, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit nga fillimi i projektit në fazën e parë e në vazhdim.

Brenda dates 30.07.2018

14. Gjetje: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të mallrave në marrjen në dorëzim të mallrave nuk ka gjetur zbatim ligji nr.9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, dhe “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, kjo për kontratat:

- "17 kamionë vetshkarkues, me karroceri të sheshtë dhe një strukturë për grumbullimin e mbeturinave", në shumën 390,915 Euro, lidhur me kompaninë "A...." shpk, datë 20.03.2013, për arsye se nuk është ngritur komision për marrjen në dorëzim të mallrave, nuk ka fletëhyrje në KRWM si dhe fletëdalje provizore, në një kohë që janë kontabilizuar dhe figurojnë në listën e inventarit dhe në bilancin e vitit 2012. Nga auditimi konstatohet se në çdo rast në akt dorëzime, nuk ka autorizim, për tërheqjen e mallrave dhe në të shumtën e herës nuk ka emër se kush i ka tërhequr ato. Me ndarjen e re territoriale nuk ka rishikim të dokumentacionit për të vërtetuar kalimin e mjeteve në bashkitë e reja.

- "Blerje fadrome", me kontraktor "T...." shpk, me vlerë kontrate 67,700 Euro, pasi për mjetin, nuk është ngritur komision për marrjen në dorëzim si dhe nuk ka fletëhyrje në KRWM. Ato janë kontabilizuar dhe figurojnë në listën e inventarit dhe janë rregjistruar në bilancin e vitit 2013. Mjeti mbahet në përdorim nga fadromisti pa asnjë dokumentacion dhe në mënyrë private.

- "Furnizim me kontenierë dhe kosha për mbledhjen e mbetjeve", në shumën 239,000 Euro pa tvsh, me kontraktorin "E....", Gjermani, është mbajtur protokoll i pranimit të mallrave i firmosur vetëm nga Administratori i Përgjithshëm, nuk është ngritur komision për marrjen në dorëzim si dhe nuk janë prerë fletëhyrje, pavarësisht se vlera është kontabilizuar, sipas furnizimeve të kryera. Nga auditimi konstatohet se në çdo rast në fletëdalje marrësi nuk ka autorizim dhe në përgjithësi nuk ka emër por vetëm nënshkrim, për tërheqjen e mallrave.

Rekomandim: KRWM sha, të marrë masa për rishikim të dokumentacionit për të vërtetuar kalimin e mjeteve në bashkitë e reja, me ndarjen e re territoriale dhe të plotësojë dokumentacionin, bazuar në kërkesat e UMF nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Brenda dates 30.07.2018

Rekomandim: KRWM sha, të marrë masa të menjëhershme për përdorimin e fadromës në përputhje me qëllimin e përcaktuar sipas projektit të menaxhimit të mbetjeve urbane, bazuar në dokumentacionin argumentues dhe justifikues, të bëhet hyrje në KRWM sha, si dhe të dokumentohet vendqëndrimi i tij.

Brenda dates 30.07.2018

Rekomandim: KRWM sha, të marrë masa të menjëhershme për identifikimin e personave që kanë tërhequr kontenierë dhe kosha për mbledhjen e mbetjeve, si dhe të vërtetojë kalimin e e tyre në Bashkitë e reja, me ndarjen e re territoriale, duke plotësuar dokumentacionin bazuar në kërkesat e UMF nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Brenda dates 30.07.2018

16. Gjetje: Me ndarjen e re territoriale, me procesverbalin e mbledhjes së zakonshme të asamblesë së përgjithshme të KRWM, datë 13.05.2016, në pikën 7, "Miratimi i buxhetit të KRWM sha për vitin 2016, është përcaktuar se detyrimet e ish komunave të mos pasqyrohen në buxhetin e vitit 2016, por të buxhetohen vetëm detyrimet e ish Bashkive, duke hequr detyrimin e kontributit financiar të ish komunave (ish aksionere) në shumën prej **9,408,348 lekë**, dhe **që përbën të ardhur të munguar në buxhetin e KRWM.**Në Vendimin e Asamblesë nr.1, datë 13.05.2016, nuk është marrë vendim për shumën 9,408,348 lekë për t'u hequr detyrimi. Procesverbali i mbledhjes së zakonshme nuk është firmosur nga asnjë nga pjesëmarrësit në mbledhje.

Rekomandim: KRWM sha dhe Këshilli Mbikqyrës të marrë masat për identifikimin dhe transferimin e vlerës prej **9,408,348 lekë**, sipas ndarjes së re territoriale, të kontabilizojë shumën e mësipërme, duke nxjerrë detyrimin çdo bashkie përkatëse.

Brenda datës 30.07.2018

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje: Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt: “Menaxhimi i mbetjeve të qarkut Korçë” SH.A (KRWM SH.A) u konstatua se, është financuar kontraktori “G...” për zëra punimesh të pakryera si dhe për likuidim zërash Lump sum të pa shoqëruara me dokumente justifikuese duke përfituar padrejtësisht **shumën 303,884 Euro**.

Rekomandim: KRWM sh.a, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “G...”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **303,884 Euro**, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Brenda datës 30.07.2018

2. Gjetje: Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt: “Punime për përmirësimin dhe rehabilitimin e kushteve të punës dhe kushteve mjedisore të fushave ekzistuese të përzgjedhura të mbetjeve” u konstatua se, është financuar kontraktori “C...” për zëra punimesh të pakryera si dhe për likuidim zërash Lump sum të pa shoqëruara me dokumente justifikuese duke përfituar padrejtësisht **shumën 15,692 Euro**.

Rekomandim: KRWM sh.a, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “C...”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **155,692 Euro**, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Brenda datës 30.07.2018

3. Gjetje: Nga auditimi i likuidimit të kontratës me objekt “**Menaxhimi i mbeturinave të ngurta në juglindje të Shqipërisë**”, të lidhur me operatorët “G...” date 04.08.2015, me vlerë kontrate pa tvsh në shumën 5,669,745.57 Euro dhe tvsh e paguar nga kosto lokale rezultoi se në këtë marrëveshje kontratë, është përcaktuar se “Marrëveshja do të ekzekutohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.”, rezulton se nuk ka gjetur zbatim ligji 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, nenet 12 e 18, si dhe UKM nr 2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, dalë në zbatim të këtij ligji, për arsye se janë likuiduar në situacionet e punimeve të ndërtimit makineri e pasije me vlerën 20% tvsh, sa vijon: **shumën 27,899,476 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga subjekti.**

Rekomandim: KRWM sh.a, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “G...”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **27,899,476 lekë**, vlerë e cila përfaqëson tvsh e likuiduar për makineri e pasije.

Brenda datës 30.07.2018

4. Gjetje: Gjatë gjithë periudhës së mandatimit të tij, për mbledhjet e pretenduara të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, janë mbajtur procesverbale mbledhjesh, me shkrim dore në blloqe të ndryshme, të cilat nuk janë firmosur në asnjë rast nga anëtarët e këshillit. Për rrjedhojë shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikqyrës për vitet objekt auditimi, **në shumën 3,245,800 lekë, përbën dëm ekonomik për shoqërinë**, për arsye se është marrë në kundërshtim me statutin e shoqërisë kapitulli II, “Këshilli Mbikqyrës”, ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe eneteve publike”, VKM nr.642, datë 11.10.2005, “Mbi funksionim e këshillave mbikqyrës të shoqërive aksionere”, sipas së cilit, ky shpërblim i rimburohet anëtarit të këshillit mbikqyrës në funksion të realizimit të detyrave të ngarkuara nga këshilli mbikqyrës.

Rekomandim: KRWM sh.a/ Administratori i Përgjithshëm të marrë të gjitha masat e duhura administrative dhe gjyqsore, për arkëtimin e shumës **3,245,800 lekë**, përfituar padrejtësisht nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, sipas tabelës nr.1, “Ndalesat për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Brenda datës 30.07.2018

5. Gjetje: Aksionerët e KRWM sh.a janë aktorët kryesorë të cilët me vullnetin e tyre mbështesin aktivitetet dhe ecurinë e Projektit. Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta "Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë" (KRWM sh.a), të miratuar në Këshillat Bashkiake të të gjithë aksionerëve, sipas nenit 4, palët marrin përsipër financimin e veprimtarisë së KRWM sh.a", për kryerjen sa më të mirë të funksionit dhe të autoritetit të transferuar, nga këto burime të tyre:

1. të ardhurat e përfituara nga tarifat për pastrimin;
2. të ardhura të tjera që përfitohen nga tarifa dhe/ose taksa që lidhen me administrimin e mbetjeve;
3. fonde financiare të tjera sipas vendimeve të Këshillave Bashkiake dhe Komunale" etj.

Financimi i aksionerëve të KRWM sh.a, është parakusht i panegociueshëm për lëvrimin e mëtejshëm të 11,8 milion Euro nga Banka Gjermane për Zhvillim, sipas marrëveshjes së ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Nga auditimi rezultoi se në kundërshtim me marrëveshjen e financimit, ligjin nr. 102/2013 datë 25.03.2013, me nenin 3 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, nenin 4 të marrëveshjes së bashkëpunimit për Krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, aksionerët e shoqërisë gjatë gjithë periudhës së funksionimit të KRWM sh.a, nuk kanë qënë të rregullt me kryerjen e pagesave të kontributeve ndaj shoqërisë, duke vënë në vështirësi serioze mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë, si njësi zbatuese e projektit për plotësimin e detyrave të caktuara nga marrëveshjet e financimit, duke rrezikuar në këtë mënyrë ecurinë e vetë projektit. Për sa më sipër bazuar në statutin e shoqërisë dhe ligjet e sipër cituara ngarkohen me përgjegjësi aksionerët dhe Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë. Në bazë të marrëveshjes së lidhur midis paleve detyrimet e pa derdhura të aksionerëve, sipas përqindjes së aksioneve, për periudhën 2010-2017 janë **53,824,318** lekë. Mospagesa e detyrimeve të aksionerëve, të cilat janë të ardhurat e vetme të kësaj sh.a ndër vite dhe aktualisht, vënë në vështirësi serioze fillimin e funksionimit të landfillit të Maliqit.

Rekomandim: KRWM sha/ Njësia e zbatimit të projektit, të marrë masat e nevojshme ligjore, për të arkëtuar pagesat e detyrimeve (kontributeve) të prapambetura të shoqërive aksionere, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe duke ezauruar të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **53,824,318** lekë, të cilat janë detyrime të pa derdhura të aksionerëve për periudhën 2010-2017, në shumat sipas Tabelës nr.2, "Detyrimet e bashkive aksionere", bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2018

C. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germa "e" dhe "ç" të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Këshillit Mbikqyrës të "Administrimi i mbetjeve të ngurta në juglindje të Shqipërisë", KRWM SH.A, Korçë, që bazuar në shkeljet e trajtuara në këtë raport përfundimtar, të analizojë dhe japë masa disiplinore:

D/I "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate", neni 9 shkronja "b", të kontratës individuale, për 1 drejtues, sa vijon:

1- V.K., me detyrë Administratore e Përgjithshme e Shoqërisë "Administrimi i mbetjeve të ngurta në juglindje të Shqipërisë", KRWM sh.a, Korçë.

D/2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Administratorit të Përgjithshëm të Shoqërisë të “Administrimi i mbetjeve të ngurta në juglindje të Shqipërisë”, KRWM SH.A, Korçë, që bazuar në shkeljet e trajtuara në këtë raport përfundimtar, të japë masa disiplinore:

- **“Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, neni 9 shkronja “b”, të kontratës individuale, për 1 drejtues, sa vijon:**

1- D. K., me detyrë Drejtor Teknik.

D. TË TJERA

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e rradhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

Rekomandimet për zbatimin e rekomandimeve të rezultuara të pazbatuara nga auditimi i ushtruar “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në periudhën Korrik-Shtator 2017, do të përcillen në subjekte gjatë muajit qershor 2018. Për çdo subjekt do të përcillet pjesa e vetë nga Vendimi i Kryetarit dhe Raporti përfundimtar.

Me ndjekjen dhe zbatimin e detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Departamenti i Auditimit të IT dhe Projekteve me Financime të Huaja.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R